LEXMARK LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Çështje azili
- Apelime kundër dëbimit

Ne ju mbështesim me përkushtim dhe transparencë në çdo fazë të procesit.

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.

The Law Society

THAMES VALLEY CHAMBER OF COMMERCE GROUP

Legal awards 2021

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239 High Road, Wood Green, London N22 8HF


www.lexmarklegal.com

The Albanian

VITI I 23 I BOTIMIT 25 QERSHOR 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

BRITANIA E MADHE, HOME OFFICE ME NJË VERSION TË RI PËR SHTETËSINË!



PETRIT KUÇANA

DIASPORA, PROTESTA DHE SAMITI I VËRTETË





DAUT DAUTI INTELEKTUALI QË NDËRTOI URA MES KOSOVËS DHE BRITANISË PËRMES GAZETARISË, HISTORISË DHE DIJES


NJË VERSION I RI PËR SHTETËSINË

ARBEN MANAJ



PIKTORI NDËRTON NJË SHQIPËRI KU NUK DO TË KETË VEND PËR SHQIPTARËT!

KIM MEHMETI



BOJA E OKTAPODIT

SONILA MEÇO



ZGJIDHJA NGA SHESHI, POLITIKA APO SPAK?

LUTFI DERVISHI



FILLIMI I FUNDIT TË PUSHTETIT TË RAMËS

VETON SURROI





Rashid A.Khan Solicitor (Principal)Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON , LONDON SW19 1AX


RASHID and RASHID LAW FIRM

RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

The Albanian newspaper in London
THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk
albania7@gmail.com
Tel: 020 7018 7929



DIASPORA, PROTESTA DHE SAMITI I VËRTETË

PETRIT KUÇANA

Ka rënë poshtë çdo lloj iluzioni që protestat në Tiranë mund të veniteshin. Mbase askush nuk e vë në dyshim se atje po shkruhet historia.
Shqiptaria nuk është më e njëjta, ajo e përgjumura, e shkalafitura, e shkimura, e para 3-4 javëve.
Shqipëria tashmë është buçima e jashtëzakonshme e 'Gen Z' që shkundi çdo lloj përceptimi të pluhërosur, për pamundësinë e një shkundjeje të shoqërisë.
Është goxha e vështirë që të gjesh një media prestigjioze botërore, që nuk shkroi këto ditë për Shqipërinë dhe që nuk ngjalli krenari për shqiptarët kudo që janë, sidomos në diasporë.
Shqipëria nuk është më ai vendi që prodhon emigrantë të paligjshëm, trafikantë, të burgosur etj etj.
Është vendi që proteston, është vendi që është kthyer në qendër të vëmendjes botërore.
Kurrë në historinë e këtij vendi, nuk ka patur një protestë të tillë në përmasa dhe kohështrirje.
Nuk ka pasur kaq shumë larmishmëri, që jo vetëm e zuri gafil çdo mjet propagande sado të sofistikuar, por mbreti mbeti lakuriq.
Gjithçka është e bukur në ato protesta, që nga pjesëmarrja, qytetaria, memet, të qenurit në modë për të dalë në protestë e deri tek rebelimi për një 'ndal!' të pushtetit të pakontrollur të një dekade e gjysmë.
E pamundur për të luftuar me të gjithë, propaganda po mundohet me çdo kusht, të shkoqisë ndonjë, kushdoqoftë, që ta përbaltë deri në palcë, por e gjitha duket krejtësisht e papërfillshmë përballë frymës së krijuar. Tashmë nuk kemi më opozitën e pozitës fjalë të ditës.



Jo! Thuajse ata janë zhdukur dhe ngadalë ngadalë po shfaqet edhe opozita e pushtetit edhe brenda rradhëve të rreshkura, të ndryshkura..
Ka një të veçantë që mund të konsiderohet edhe si historike; 'përfshirja' e diasporës.
Nuk ka një vend të botës që nuk u organizuan protesta nga diaspora.
Kryesisht përpara ambasadave, por edhe në sheshe a parqe të ndryshme, që i shtuan dimensionin mbarëkombëtar këtyre protestave që shkundën Shqipërinë.
Mbase pjesëmarrja në protestën në Shqipëri, ishte edhe pika kulminante. Me qindra makina të nisura që nga Britania e Madhe dhe thuajse nga e gjithë Evropa, vërshuan drejt Tiranës duke shtuar jo vetëm radhët e protestuesve, por duke transmetuar 'kumtin' e fuqishëm se diaspora është krah jush, si përherë.
Kushedi sa të turpëruar do të jenë ndjerë ata pjesëmarrës apo ligjërues në të ashtuquajturat samite, që lartësonin punën e jashtëzakonshme të partisë…pushtetit..

Ajo thjesht i takon historisë, si një njollë turpi që shfaq karaktere…
Ky po që ishte samiti i parë ,i vërtetë, i diasporës shqiptare. Janë ato fjalimet përpara ambabasadave, në ato grumbullimet përpara ambasadave, e deri tek protesta e madhe në Tiranës, që plotësoi nuancat e një samiti të vërtete, larg cdo lloj propagande me regji të përcaktuar, por e rrjedhshme, e natyrshme…
Po, diaspora është aty, krejtësisht e papërkulshme ndaj asgjëje dhe se, ka marrë fund radhitja (renditja) në sallat ku kryeministri do të vijë të mbajë ndonjë fjalim të stërgjatë dhe do ta konsiderojë si 'takim me shqiptarët e atyshëm, e madje do të shkonte deri në përgjakje të ndonjë protestuesi, që do të 'guxonte' të kundërshtonte fjalimin e kryeministrit.
Tashmë nuk mund të ketë më të tillë dhe se thjesht dëshmoi se qeveria e tij ka dështuar terësisht, sidomos në marëdhënie me diasporën. Kur ka një dekadë e gjysëm në pushtet nuk ka akoma një listë të doktorantëve shqiptarë nëpër botë, nuk ka qoftë edhe një listë të ambasadorëve të shkëlqyer shqiptarë nëpër botë.
Nuk ka një listë të bizneseve që mund të ishin investitorë strategjikë, apo të studentëve që po shkollohen në universitetet më prestigjioze të botës.
Me siguri kanë listën e patronazhistëve të diasporës, por pas protestës që po vazhdon në Tiranë duket se do të mbetet thjesht lista e turpit…



LEXMARK
LEGAL

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.



SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apelime dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.
Ekspertë të besuar të imigracionit.

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

DORËHEQJA E STARMER-IT DHE SIGURIA E EVROPËS

Keir Starmer ishte pjesë integrale e grupit të politikanëve që mbështesnin Ukrainën. Çfarë e pret pasardhësin e tij, dhe çfarë mund të pritet prej tij?

Megjithëse Keir Starmeri mund të mos ishte i preferuar nga publiku britanik, ai me shumë gjasa kishte disa miq mes figurave kryesore politike të BE-së. Për shembull, Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e falënderoi me këto fjalë: 'Siguria evropiane dhe ukrainase është më e fortë falë jush'.

Edhe Presidenti francez, Emmanuel Macron, shprehu mirënjohjen e tij për angazhimin e Starmer-it në 'Koalicionin e të Vullnetshmëve' dhe për rivitalizimin e marrëdhënieve midis BE-së dhe Britanisë së Madhe.



Forcë lëvizëse pas 'Koalicionit të të Vullnetshmëve'

Keir Starmer tërhoqi vëmendjen në Evropë, veçanërisht si një mbështetës i Ukrainës. Së bashku me presidentin francez Emmanuel Macron, lideri britanik udhëhoqi 'Koalicionin e të Vullnetshmëve'. Kjo aleancë, që përbëhet nga rreth 35 shtete, mbështet Ukrainën me ndihmë ushtarake dhe, sapo të arrihet një armëpushim, synon të ndihmojë Ukrainën të sigurojë kapacitetet e saj të mbrojtjes afatgjatë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenski gjithashtu e pranoi këtë mbështetje. Ai e falënderoi për "bashkëpunimin, mbështetjendhe vendimet e përbashkëta që kanë ndihmuar në forcimin e Evropës sonë dhe mbrojtjen e jetëve tona".

Keir Starmer ka qenë një partner shumë "aktiv" dhe "i besueshëm" për homologët e tij në 'Koalicionin e të Vullnetshmëve', thotë Olivia O'Sullivan, drejtoreshë e programit "Britania e Madhe në botë" në qendrën kërkimore me bazë në Londër, Chatham House.

Kështu, së bashku me udhëheqës të tjerë shtetërorë evropianë, ai ka reflektuar mbi mënyrën se si Europa mund të luajë një rol strategjik në sigurimin e paqes. Në të njëjtën kohë, megjithatë, ai e pati të vështirë të siguronte burimet financiare të nevojshme për të përmbushur objektivat e shpenzimeve ushtarake që i kishte vendosur vetes. Ky është një sfidë me të cilën do të përballet edhe kryeministri i ardhshëm britanik.

Roli i Britanisë së Madhe në formatin E3

Britania e Madhe gjithashtu mbron Ukrainën brenda formatit E3. Kjo është një aleancë midis Gjermanisë, Francës dhe Britanisë së Madhe për të koordinuar çështjet e politikës së jashtme dhe sigurisë.

Ekspertja politike Olivia O'Sullivan beson se kjo kornizë është një forcë lëvizëse pas strategjisë evropiane, jo vetëm në lidhje me krizën në Ukrainë, por edhe në marrëdhëniet me qeverinë e SHBA-së, e cila po luan një rol gjithnjë e më pak të rëndësishëm dhe të parashikueshëm në çështjet e sigurisë evropiane.

Formati E3 gjithashtu synon të përgjigjet rregullisht kërkesave të SHBA-së, si në deklaratat për mënyrën se si evropianët kanë ndërmend të kontribuojnë në sigurinë në Ngushticën e Hormuzit pas një armëpushimi.

Megjithëse analistja politike O'Sullivan nuk e sheh faktin që partnerët evropianë tani duhet të përshtaten me një kryeministër të ri britanik si një pengesë, ajo pret që kjo të rezultojë në një humbjeje të vogël të dinamikës.

Të gjitha varen nga pasardhësi

Zhvillimi i ardhshëm i marrëdhënieve të Britanisë së Madhe me BE-në dhe partnerët e saj evropianë do të varet, para së gjithash, nga personi që do ta zëvendësojë Keir Starmer. Aktualisht, të gjitha shenjat tregojnë se ish-kryebashkiaku i Manchesterit, Andy Burnham, do të bëhet kryeministri i ardhshëm britanik. Burnham konsiderohet, në kuptimin më të gjerë, si proevropian, thekson O'Sullivan për DW.

Ajo pret që ai, në thelb, të mbajë kursin e Starmer-it sa i përket BE dhe Ukrainës. Megjithatë, ende nuk është e qartë në detaje se si do të pozicionohet ai në politikën e jashtme dhe atë të sigurisë, pasi deri tani është përqendruar kryesisht në politikën e brendshme.

Vlen të pyetet gjithashtu nëse Burnham do ta konsiderojë politikën e jashtme si një prioritet, ashtu siç bëri Keir Starmer. Starmer dëshironte 'fillim të ri' në marrëdhëniet me BE

Analistja politike O'Sullivan konsideron se një nga arritjet kryesore të qeverisë së Starmerit ishte nënshkrimi i një partneriteti sigurie midis BE dhe Britanisë së Madhe vitin e kaluar, gjatë samitit të parë BE–Britani e Madhe që u mbajt që nga Brexit. Keir Starmer kishte kërkuar për një 'fillim të ri' në marrëdhëniet me BE-në dhe kishte arritur një afrim në disa fusha, si p.sh. në peshkim dhe shkëmbime rinore.

Marrëveshja e sigurisë BE–Britani e Madhe synon të lehtësojë një bashkëpunim më të madh në mbështetje të Ukrainës ose në iniciativa të sigurisë dhe mbrojtjes, dhe parashikon një dialog të rregullt.


Megjithatë, sipas O'Sullivan, suksesi i samitit të parë është disi i zbehur nga aksesi shumë i kufizuar i Britanisë së Madhe në programin SAFE të BE-së.

Kjo është një hua e BE-së me vlerë 150,000 milionë euro, e cila mund të përdoret për të financuar, ndër të tjera, prokurimin e përbashkët të pajisjeve mbrojtëse. Pjesëmarrja e plotë e Britanisë së Madhe dështoi në nëntor të kaluar për shkak të mungesës së dëshirës së Britanisë së Madhe për të paguar një tarifë pjesëmarrjeje.

Pa dyshim, forma e ardhshme e marrëdhënieve me BE-në do të jetë gjithashtu një preokupim për kryeministrin e ardhshëm britanik. BE duket e gatshme të presë për të.

Presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, njoftoi të hënën se samiti BE–Britani e Madhe, i planifikuar për 22 korrik, është shtyrë për momentin.

dw



Dotech website

NO WEBSITE?
NO CUSTOMERS



Akoma nuk keni një website ? !!

Akoma nuk jeni regjistruar në Google ? !!

Suksesi fillon nga nje website profesionale ✍️

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

ADRESA E ZYRAVE:

30 Avenons Road,
London, E13 8HT

NE MUND T'IU NDIHMOJME EDHE ME:

- Business Cards
- Logos
- Posters
- Banners

WEBSITES THAT GROW YOUR BUSINESS

MODERN SECURE RESPONSIVE

RANK HIGHER GET FOUND GET MORE CLIENTS

SUPPORT YOU CAN COUNT ON

INVESTO SOT, FITO NESËR!

NJË WEBSITE PROFESIONALE ËSHTË HAPI I PARË DREJT SUKSESIT TËND.

BRITANIA E MADHE, HOME OFFICE ME NJË VERSION TË RI PËR SHTETËSINË!

ARBEN MANAJ

Ka qënë apelimi në Gjykatën e Lartë britanike e politikës së shkurtit të 2025-es, së qeverisë britanike të Starmër dhe Ministres së Brëndshme Shabanna Mahmood, për kriteret e dhënies së shtetësisë britanike që përbënte një ndryshim drastik për kriteret që duhej të plotësonin aplikantët, duke sanksionuar që nëse një person i ardhur ndonjëherë në Britani ilegalisht i refuzohej automatikisht kërkesa pa konsideruar asnjë faktor tjetër lehtësues, ajo qe Home te ofroj një version të ri të kësaj politike të konsideruar diskriminuese.

Në seancën e para pak ditëve në Gjykatën e Lartë në Londër, palët kanë rënë dakort të mos vazhdohej me shqyrtimin e kërkesës kundër qeverisë për arsye se Home Office, ka publikuar më 30 Prill 2026 një version të ri të politikës së marrjes së shtetësis britanike, në lidhje me karakterin e aplikuesve, ku qartësohet se një aplikim për shtetësinë britanike nuk duhet të refuzohet automatikisht, nëse aplikuesi ka hyrë në Britani ilegalisht.

Për personat që kanë aplikuar dhe aplikojnë nga data 30 Prill 2026 e në vazhdim, aplikimet e tyre do të shqyrtohen në bazë të politikës së re të Home Office to përditësuar nga kjo datë, thotë për Top-Channel në Londër avokati Naim Hasani.(Sipas tij, shumë shqiptar e kanë pritur me ankth se cfarë do të vendoste Gjykata dhe nëse do ta vlerësonte të paligjshme politikën e Home Office të dates 10 Shkurt 2025.)



Cdo aplikim duhet të shqyrtohet tashmë në bazë të meritave të secilit aplikues dhe në rastet e hyrjes ilegale zyrtarët e Ministrisë së Brëndshme dhe Emigracionit, duhet të shqyrtojnë me kujdes dhe të marrin vendime të konsideruara, sidomos në rastet kur aplikuesi ka qënë fëmijë, kur ka hyrë në Britani ilegalisht, apo në rastet kur ka hyrë në Britani ilegalisht dhe ka qënë që në fillim të udhëtimit për në Britani nën kontrollin e trafikantëve e nuk kanë qënë të lirë të vendosin vetë se ku te shkojnë.

Me theks të vecante kjo për viktimat e trafikimit dhe po ashtu në rastet kur aplikuesit kanë ardhur në Britani ilegalisht, dhe kur kanë aplikuar për azil, kanë qënë të suksesshëm në kërkesat e tyre, duke përfituar statusin e refugjatit.

(Në këtë mënyre hapet mundësia që këto kategori personash të mund të argumentojne se kualifikohen për shtetësinë britanike, për t'i kërkuar Home Office që të rikonsiderojnë refuzimin e cështjeve të tyre dhe nese ju refuzohet përsëri shtetësia britanike, të këshillohen me avokatët nëse mund ta cojnë cështjen në Gjykatën e Lartë britanike për të kundërshtuar këto vendime).

Discover The Latest Trends in Technology

Dotech website

" AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? "



Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT

Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545

"SHQIPËRI E RE"/ THE GUARDIAN: REVOLTA KUNDËR RESORTIT TË KUSHNER KTHEHET NË PROTESTË KUNDËR QEVERISË



Për Ina Shkurtin, ashtu si për shumë shqiptarë të tjerë, ishulli i Sazanit ka qenë gjithmonë një vend i veçantë. Në fëmijëri ajo lahej në ujërat e tij "të qeta dhe smerald", në adoleshencë ishulli ishte pjesë e ëndrrave të saj, ndërsa në moshë madhore u bë një pjesë e pandashme e kujtimeve dhe nostalgjisë që e rikthenin çdo verë në Vlorë, qytetin e saj të lindjes.

Ajo që Shkurti nuk e kishte imagjinuar kurrë ishte se planet për ndërtimin e një mega-resorti në Sazan, një nga dy resortet luksoze në bregdetin jugor të Shqipërisë të mbështetura nga Ivanka Trump dhe bashkëshorti i saj, Jared Kushner, do të shkaktonin një revoltë që ka tronditur vendin. The Guardian ka ndarë disa histori si ato të Inës.

"Sazani është i vetmi ishull i Shqipërisë. Është një parajsë e vogël që zë një vend të veçantë në zemrën dhe mendjen e shqiptarëve. Që një çift i pasur të vijë, ta zhvillojë dhe më pas të na mohojë aksesin, do të ishte një krim", thotë kartografja.

Shqipëria nuk kishte përjetuar një zemërim kaq të gjerë shoqëror, që prej rënies së komunizmit, më shumë se tre dekada më parë. Në moshën 32-vjeçare, Shkurti, familja e së cilës emigroi në Shtetet e Bashkuara kur ajo ishte 11 vjeç, përfaqëson profilin e dhjetëra mijëra shqiptarëve, brenda dhe jashtë vendit, që i janë bashkuar protestave. Kjo lëvizje është quajtur tashmë "revolucioni i flamingove", për shkak të rrezikut që resortet e planifikuara paraqesin për jetën e egër dhe ekosistemet e brishta të zonës.

"Kjo qeveri nuk na përfaqëson më", shprehet ajo. "Ajo ka zgjedhur të përfaqësojë investitorë oligarkë si Ivanka Trump dhe Jared Kushner. Këto protesta nuk do të ndalen, nuk kanë më të bëjnë vetëm me ta."

Çdo ditë, tregon Ina, miq të diasporës shqiptare po kthehen në atdhe për t'iu bashkuar protestave. Në demonstratën më të madhe deri tani, mijëra njerëz u mblodhën në Tiranë gjatë fundjavës. Shumë prej tyre të ardhur nga Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera europiane.

Në një vend ku protestat qytetare nuk kanë qenë kurrë pjesë e fortë e kulturës politike, këto tubime, pa drejtues dhe pa ngjyra partiake, kanë befasuar si autoritetet në Tiranë, ashtu edhe Bashkimin Europian. Gjithnjë e më shumë, zemërimi i protestuesve po drejtohet ndaj të gjithë klasës politike, të cilën e konsiderojnë përgjegjëse për tranzicionin e Shqipërisë pas rënies së regjimit komunist.

Mes thirrjeve të përditshme për largimin e tij, kryeministri Edi Rama ka reaguar herë me nervozizëm, herë me humor, e herë me irritim. I rizgjedhur për një mandat të katërt vitin e kaluar me premtimin për ta çuar Shqipërinë drejt Bashkimit Europian, Rama e ka cilësuar investimin prej 1.4 miliardë eurosh si vendimtar për ta kthyer vendin në destinacionin më tërheqës turistik luksoz të Mesdheut.

"Pyetja është ku do të përfundojë e gjithë kjo," thotë Afrim Krasniqi, drejtor i Institutit të Studimeve Politike, i cili nuk përjashton mundësinë që protestuesit të kalojnë në forma më radikale të reagimit. "Qeveria duket sikur nuk do ta pranojë se të gjithë këta njerëz që kanë dalë në rrugë janë kundër saj. Kjo mungesë dialogu, kjo mungesë empatie dhe ky refuzim për të gjetur një zgjidhje është i rrezikshëm."

Kanë kaluar tre javë që kur protestat shpërthyen, pasi mjetet e rënda nisën pastrimin e pyjeve dhe dunave për t'i hapur rrugë ndërtimit në një zonë të mbrojtur përballë Sazanit. Rezervati i Pishë Poro-Nartës, ku ndodhet një nga lumenjtë e fundit të egër të Europës, përfshin një pjesë të madhe të gadishullit të Zvërnecit. Laguna shërben si koridor migrimi për qindra lloje shpendësh të rrallë dhe mbi 70 specie të rrezikuara.
Tensionet u rritën pikërisht në këtë zonë, e para e planifikuar për zhvillim, kur kundërshtarët e projektit u përplasën me rojet private që kishin ngritur një gardh për të ndaluar hyrjen. Teksa protestuesit përpiqeshin të kapërcenin barrierën, një qytetar u tërhoq zvarrë nga rojet e sigurisë, me duar të lidhura. Pamjet shkaktuan indinjatë, ndërsa policia nuk ndërhyri.

Një ditë më vonë, u rishfaq një podcast ku Ivanka Trump fliste me entuziazëm për projektin dhe për "këtë gadishull të mrekullueshëm me lagunë nga njëra anë dhe det nga ana tjetër", të cilin ajo dhe bashkëshorti i saj, Jared Kushner, si investitorë kryesorë, synojnë ta transformojnë.

"Është një projekt gjigant," tha ajo për planet në Sazan, ish-bazën ushtarake të periudhës komuniste, ku peizazhi i mbuluar me fiq të egër dhe lule është ende i mbushur me ndërtesa të braktisura që dikur strehonin ushtarakët dhe familjet e tyre.

"Jo vetëm ishulli, por kemi edhe pesë milje vijë bregdetare përballë tij," shtoi vajza e presidentit amerikan, duke iu referuar zonës ku ndodhën përplasjet e këtij muaji.

"Njerëzit u zemëruan shumë," thotë ambientalisti Kostandin Xhaho nga Vlora. "Sazani është një monument historik. Kam miq që janë rritur në ato ndërtesa dhe si ishulli, ashtu edhe Zvërneci janë habitate të rëndësishme për flamingot, fokat murgeshë dhe breshkat detare. Ideja e një resorti me 10 mijë dhoma në gadishull shkaktoi një zemëratë të madhe."

Mundësia që, sipas kritikëve, "elita më e keqe globale" të ndërhynte në rezervate natyrore të një prej vendeve më të varfra të Europës, nxori në pah pakënaqësi më të gjera ndaj pabarazive dhe abuzimeve. Projekti mori miratim paraprak pasi Kuvendi ndryshoi ligjet që mbronin zonat e ndjeshme mjedisore.

Për shumë kundërshtarë të projektit, mungesa e transparencës mbetet një shqetësim madhor. Ata pretendojnë se identiteti i investitorëve fshihet pas një strukture të ndërlikuar kompanish në Holandë.

"Ne duam një Shqipëri të re," thotë 24-vjeçarja Justina Prenga, e cila udhëtoi nga Shkodra për t'iu bashkuar protestuesve në Tiranë, ku çdo mbrëmje dëgjohen thirrjet "Rama ik" para godinës së Kryeministrisë.

"Jemi brezi Z dhe po themi 'mjaft më'. Ky vend nuk është në shitje". Sipas saj, zemërimi tashmë ka shkuar shumë përtej familjes Kushner.

I mbështjellë me një flamur të madh kuqezi, Lizander Saraçi, menaxher risku në një bankë private dhe baba i dy fëmijëve, është një nga shumë qytetarët e një brezi më të vjetër që i janë bashkuar protestave.

"Kanë kaluar mbi 30 vjet dhe spitalet tona vazhdojnë të jenë në gjendje të keqe, arsimi lë për të dëshiruar, nuk ka vende pune dhe të rinjtë po largohen," thotë ai. "Njerëzit po dalin në rrugë sepse janë lodhur nga padrejtësia dhe korrupsioni. Një nga sloganet tona është 'ndal diktaturën e parave të pista', sepse kemi parë se projekte të tilla përfitojnë vetëm një grusht njerëzish të pasur."

Javën e kaluar edhe Parlamenti Europian reagoi. Në një rezolutë, eurodeputetët mbështetën protestuesit dhe i kërkuan qeverisë shqiptare të ndalojë ndërtimet në zonat e mbrojtura. Disa prej tyre dënuan veprimtarinë e "kapitalistëve grabitqarë", të cilët kanë përfituar nga ligjet që u japin investitorëve strategjikë procedura të përshpejtuara. Brukseli e ka kritikuar prej kohësh këtë legjislacion dhe ka kërkuar ndryshimin e tij. Zyrtarët europianë paralajmërojnë se pa përputhjen e ligjeve mjedisore me standardet europiane, negociatat e anëtarësimit nuk mund të përmbyllen.
"Prisnim që Shqipëria, vetëm një vit e gjysmë larg objektivit të saj për integrim, t'i kishte përafruar tashmë këto standarde me ato të Bashkimit Europian," deklaroi ambasadori i BE-së në Shqipëri, Silvio Gonzato.

Megjithatë, Rama vazhdon ta mbrojë projektin. Ai ka premtuar se zhvillimi në Zvërnec do të vijojë mbi bazën e një vlerësimi mjedisor sipas standardeve të BE-së dhe e ka quajtur investimin "një bekim" për vendin, duke argumentuar se do të krijojë vende pune dhe do të shtojë sipërfaqet e gjelbra. Vitin e kaluar, Shqipëria me rreth tre milionë banorë priti afro 12 milionë turistë, të tërhequr si nga bukuritë natyrore, ashtu edhe nga kostot relativisht të ulëta.

"Pyetja është se çfarë modeli zhvillimi duam," thotë Ina Shkurti. "A ka kuptim të ecim në këtë drejtim kur infrastruktura ekzistuese mezi përballon fluksin aktual?"

Megjithatë, projekti ka edhe mbështetësit e vet. Albert Pushka, pronar i një restoranti të ri peshku pranë Vlorës, është aq entuziast sa e ka quajtur biznesin e tij "Ivanka".

"Shqipëria duhet të ecë përpara. Duhet ta shfrytëzojë këtë mundësi. Nëse nuk e bëjmë ne, do ta bëjnë grekët," thotë 48-vjeçari Walter Dimraj.

Ndërsa Elpiniqi Merkuri, psikologe dhe kryetare e Këshillit Bashkiak të Vlorës, beson se resorti do të sjellë optimizëm dhe besim në të ardhmen.

"Njerëzit ndihen më të qetë dhe më optimistë kur shohin zhvillim, mundësi të reja dhe mjedise të kuruara," thotë ajo.

Por ornitologia Ledi Selgjekaj nuk e ndan këtë optimizëm. Prej pesë vitesh ajo monitoron jetën e shpendëve në lagunë dhe thotë se pasojat ekologjike janë tashmë të dukshme.

"Kur nisi ndërtimi i aeroportit të Vlorës, pamë menjëherë ndërprerjen e korridoreve ekologjike dhe shtimin e grabitqarëve që sulmojnë faunën e lagunës," thotë ajo.

Sipas saj, flamingot dhe foletë e tyre janë prekur veçanërisht.

"Aeroporti do të jetë një katastrofë kur të nisë funksionimin. Nëse ndërtohen edhe këto resorte, atëherë do të jetë goditja përfundimtare për ekosistemin."/ Përshtati nga The Guardian, Lapsi.al

DAUT DAUTI – INTELEKTUALI QË NDËRTOI URA MES KOSOVËS DHE BRITANISË PËRMES GAZETARISË, HISTORISË DHE DIJES



Gjilan – Në galerinë e personaliteteve shqiptare që kanë arritur të lënë gjurmë përtej kufijve të vendlindjes së tyre, emri i Daut Dautit zë një vend të veçantë. Gazetar, publicist, studiues, hulumtues dhe autor i disa veprave me vlerë historike e kulturore, ai përfaqëson modelin e intelektualit që nuk e ka parë dijen si privilegj personal, por si mision në shërbim të shoqërisë dhe kujtesës kombëtare.

Daut Dauti është një nga personalitetet më të spikatura shqiptare në fushën e gazetarisë, historiografisë dhe krijimtarisë letrare, një intelektual që ka arritur të ndërtojë me dinjitet ura komunikimi mes botës shqiptare dhe qarqeve akademike ndërkombëtare. Me një karrierë të pasur që shtrihet ndërmjet gazetarisë profesionale, kërkimit shkencor dhe publicistikës, ai përfaqëson modelin e studiuesit dhe krijuesit që e ka shndërruar dijen në mision, ndërsa fjalën e shkruar në instrument të ruajtjes së kujtesës historike dhe promovimit të vlerave kombëtare.

I njohur dhe i vlerësuar në Kosovë, Britaninë e Madhe dhe më gjerë, Dauti mbetet një zë autoritativ në trajtimin e historisë shqiptare, marrëdhënieve anglo-shqiptare dhe zhvillimeve shoqërore e kulturore të kohës sonë.

I lindur në Kokaj të Gjilanit, në një trevë të njohur për traditat atdhetare dhe kulturore, Dauti u formësua në një kohë kur fjala e lirë dhe mendimi kritik kërkonin guxim të veçantë. Studimet në fushën e drejtësisë në Kosovë dhe më pas specializimet e avancuara në Britaninë e Madhe e pajisën me një horizont të gjerë intelektual, duke e bërë një njohës të shkëlqyer të realiteteve shqiptare dhe atyre evropiane.

Rrugëtimi i tij në gazetari nisi herët, por u konsolidua përmes angazhimit në mediat më të rëndësishme shqiptare. Si korrespondent nga Londra për vite me radhë, ai u bë një urë komunikimi mes botës shqiptare dhe asaj britanike, duke sjellë analiza, informacione dhe perspektiva që ndihmuan publikun shqiptar të kuptojë më mirë zhvillimet ndërkombëtare.

Gazetaria për Daut Dautin nuk ka qenë kurrë vetëm profesion. Ajo ka qenë një formë angazhimi qytetar dhe intelektual. Në një periudhë kur Kosova po kalonte sfida të mëdha historike e politike, ai mbeti një zë i arsyes, i argumentit dhe i mendimit kritik. Kontributi i tij në zhvillimin e mediave profesionale dhe në forcimin e standardeve të gazetarisë është pjesë e trashëgimisë së tij publike.



Megjithatë, dimensioni që e veçon më së shumti Daut Dautin është puna e tij kërkimore dhe historiografike.

Ai i përket atij brezi studiuesish që kanë kuptuar se kombet nuk ndërtohen vetëm mbi ngjarjet historike, por edhe mbi kujtesën e dokumentuar me seriozitet shkencor. Përmes librave, studimeve dhe hulumtimeve të tij, ai ka nxjerrë në dritë kapituj të rëndësishëm të historisë shqiptare, duke i trajtuar me metodologji bashkëkohore dhe me një përkushtim të admirueshëm ndaj fakteve.

Veprat e tij mbi marrëdhëniet shqiptaro-britanike kanë sjellë kontribute të rëndësishme në kuptimin e rolit që diplomacia dhe politika britanike kanë pasur në çështjen shqiptare gjatë periudhave të ndryshme historike. Pikërisht ky kombinim mes gazetarit dhe studiuesit i ka dhënë shkrimeve të tij një peshë të veçantë intelektuale dhe dokumentare.

Në Londër, ku jeton dhe vepron prej vitesh, Daut Dauti nuk është shkëputur asnjëherë nga Kosova. Përkundrazi, ai ka mbetur një nga zërat më të angazhuar të diasporës shqiptare, duke promovuar kulturën, historinë dhe identitetin kombëtar në qarqe akademike e publike ndërkombëtare.

Ajo që e karakterizon personalitetin e tij është serioziteti intelektual, qasja kritike ndaj fenomeneve shoqërore dhe përkushtimi ndaj së vërtetës.

Në një kohë kur informacioni shpesh konkurron me sensacionalizmin, Daut Dauti mbetet shembull i intelektualit që beson te argumenti, dokumenti dhe analiza e thellë.

Prandaj, emri i tij nuk lidhet vetëm me gazetarinë apo historinë. Ai lidhet me një jetë të tërë të ndërtuar mbi dijen, kërkimin shkencor dhe përgjegjësinë publike. Për Gjilanin, për Kosovën dhe për komunitetin shqiptar në Britani, Daut Dauti mbetet një figurë që dëshmon se puna intelektuale e ndershme mund të ndërtojë ura të qëndrueshme mes popujve, kulturave dhe brezave.

Daut Dauti – kronisti i kujtesës historike dhe zëri intelektual i shqiptarëve në Britani

Në botën shqiptare të gazetarisë, historiografisë dhe publicistikës, pak emra kanë arritur të ndërtojnë një profil kaq të shumëanshëm dhe të respektuar sa Daut Dauti. Historian, shkrimtar, gazetar dhe studiues i përkushtuar, ai i përket atij brezi intelektualësh që dijen e kanë shndërruar në mision, ndërsa kërkimin shkencor në një urë komunikimi mes historisë shqiptare dhe botës akademike ndërkombëtare.

Me prejardhje nga Gjilani, Dauti e nisi

rrugëtimin e tij profesional në gazetarinë studentore, në gazetën "Bota e Re", gjatë kohës së studimeve në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ishin vitet kur fjala e shkruar kishte peshë të veçantë dhe kur gazetaria kërkonte jo vetëm talent, por edhe guxim intelektual. Që në hapat e parë ai dëshmoi prirjen për analizë, argumentim dhe trajtim serioz të çështjeve shoqërore e kombëtare.

Më vonë, vendosja në Londër i hapi horizonte të reja profesionale dhe akademike. Si korrespondent i gazetës "Zëri" nga kryeqyteti britanik dhe bashkëpunëtor i shumë mediave shqiptare, ai u bë një prej urave më të rëndësishme informative mes diasporës shqiptare dhe zhvillimeve politike, kulturore e akademike në Britaninë e Madhe.

Megjithatë, dimensioni më i fuqishëm i veprimtarisë së tij mbetet ai shkencor. Studimet pasuniversitare në "West London University" dhe doktoratura në histori në Universitetin e Leeds-it e vendosën atë në mesin e studiuesve shqiptarë që kanë depërtuar me sukses në qarqet akademike ndërkombëtare. Angazhimi në projekte kërkimore universitare dhe bashkëpunimi me institucione prestigjioze e kanë forcuar profilin e tij si njohës i thellë i historisë moderne shqiptare dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Interesi i tij shkencor është fokusuar veçanërisht në marrëdhëniet anglo-shqiptare gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, një fushë komplekse që kërkon qasje serioze arkivore dhe interpretim profesional të burimeve historike. Në këtë drejtim, vepra e tij monumentale Britain, the Albanian Question and the Fall of the Ottoman Empire 1876–1914, botuar nga shtëpia prestigjioze Bloomsbury Publishing, konsiderohet një kontribut i rëndësishëm në studimet mbi çështjen shqiptare dhe diplomacinë britanike në Ballkan.

Përveç punës akademike, Dauti ka shërbyer edhe në institucione publike dhe organizata ndërkombëtare. Në vitin 2005 ai ishte këshilltar për media dhe zëdhënës në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, ndërsa ka kontribuar edhe si konsultant në organizata të rëndësishme ndërkombëtare, duke sjellë përvojën e tij profesionale në fusha që lidhen me komunikimin publik, migracionin dhe politikat zhvillimore.

Ajo që e veçon Daut Dautin është aftësia për të bashkuar gazetarinë me shkencën, publicistikën me historinë dhe angazhimin qytetar me kërkimin akademik.

Në një kohë kur informacioni shpesh është i shpejtë dhe sipërfaqësor, ai mbetet shembull i intelektualit që ndërton argumente mbi dokumente, analiza mbi fakte dhe që e sheh historinë jo si rrëfim të së kaluarës, por si udhërrëfyes për të ardhmen.

Për Gjilanin, për Kosovën dhe për diasporën shqiptare në Britaninë e Madhe, Daut Dauti mbetet një nga figurat më të respektuara të mendimit shqiptar bashkëkohor – një studiues i palodhur, një gazetar me integritet dhe një kronist i kujdesshëm i historisë sonë kombëtare.





Daut Dauti sjell "Nëpër gjethe kujtimesh", një udhëtim letrar mes kujtesës personale dhe memories kolektive shqiptare

Historiani, gazetari, publicisti dhe shkrimtari Daut Dauti ka sjellë para lexuesve librin e tij më të ri, "Nëpër gjethe kujtimesh", një vepër që ndërthur rrëfimin autobiografik me historinë, kulturën dhe kujtesën kolektive të shqiptarëve.

I botuar nga Agoraprint në Prishtinë, libri paraqet një mozaik tregimesh që nisin nga fëmijëria e autorit në Kosovë dhe vazhdojnë me përvojat e jetës në mërgim, duke përfshirë veçanërisht periudhën e tij në Londër.

Vepra është e ndarë në tri pjesë: "Fëmijëria", "Tregime të mëvonshme" dhe "Tregime nga Londra", duke ofruar një pasqyrë të gjerë të transformimeve shoqërore, kulturore dhe historike që kanë shoqëruar shqiptarët gjatë dekadave të fundit.

Përmes personazheve, ngjarjeve dhe kujtimeve të sjella me gjuhë të pasur e rrëfim të natyrshëm, autori rindërton një botë që gradualisht po largohet, por që vazhdon të jetojë në ndërgjegjen kolektive të shqiptarëve.

Në recensionin e tij, studiuesi i letërsisë, botuesi dhe publicisti Emin Azemi e vlerëson librin si një shembull të arrirë të letërsisë së kujtimeve, ku përvoja individuale tejkalon kufijtë autobiografikë dhe shndërrohet në dëshmi të një kohe, të një kulture dhe të një shoqërie të tërë. Sipas tij, një nga vlerat më të mëdha të librit është aftësia e Dautit për ta kthyer kujtimin personal në rrëfim kolektiv, duke bërë që lexuesi të gjejë në faqet e veprës pjesë të historisë së vet familjare dhe shoqërore.

Nëpërmjet tregimeve të tij, autori sjell me autenticitet jetën tradicionale shqiptare, zakonet, ritualet, humorin popullor, sfidat e përditshmërisë dhe figurat karakteristike të fshatit shqiptar, të cilat përbëjnë një trashëgimi të çmuar kulturore. Personazhet që parakalojnë në këtë vepër nuk janë vetëm individë të veçantë, por përfaqësues të një bote që po zhduket nën ritmet e shpejta të modernitetit.

Një dimension të rëndësishëm zë edhe përvoja e mërgimit. Tregimet nga Londra paraqesin përplasjen dhe bashkëjetesën ndërmjet traditës shqiptare dhe realitetit të shoqërive moderne perëndimore. Me humor të hollë, ironi të mençur dhe vëzhgime të mprehta sociale, Dauti trajton çështje që lidhen me identitetin, integrimin dhe ruajtjen e lidhjeve shpirtërore me vendlindjen.

Sipas Emin Azemit, Londra në librin e Dautit nuk shfaqet thjesht si një qytet i madh evropian, por si një hapësirë ku ndërthuren historia shqiptare dhe ajo evropiane, duke i dhënë veprës dimensione më të gjera kulturore dhe historike.

"Nëpër gjethe kujtimesh" nuk është vetëm një përmbledhje tregimesh, por një dëshmi letrare për botën shqiptare që vazhdon të jetojë në kujtime, rrëfime dhe përvoja njerëzore.

Në një kohë kur memoria kolektive rrezikon të zbehet përballë ritmit të shpejtë të jetës moderne, libri i Daut Dautit vjen si një kontribut i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit kulturor dhe historik të shqiptarëve, duke dëshmuar se historia e një populli nuk ruhet vetëm në dokumente dhe arkiva, por edhe në kujtimet e njerëzve dhe në fuqinë e rrëfimit letrar./rajonipress/

NË THEMELET E SHQIPËRISË SË RE DUHET BËRË NJË KURBAN

ARMAND SHKULLAKU



Pas ngjarjeve dramatike të vitit 1997, të cilat, ndonëse me kosto shumë të lartë, i hapën rrugën një epoke shumë më demokratizuese se më parë, tani, pas gati 30 vitesh, shoqëria shqiptare gjendet në një krizë që kërkon përsëri një ekulibër të ri, hapësirë të vërtetë të demokracisë përfaqësuese, pjesmarrje të drejtë në administrimin e pasurisë publike dhe vendimarrje politiko-ekonomike me bazë sa më të gjerë. Përqëndrimi i pushtetit në duart e një njeriu të vetëm apo një grushti njerëzish rreth tij, është shkaku i parë dhe i vetëm i ngulfatjes së një populli të tërë, që sot ndihet totalisht i përjashtuar nga e drejta themelore që mban në këmbë një sistem demokratik, ajo e përfaqësimit në vendimarrje.

Nuk ka nevojë për të renditur shkaqe apo arsye të tjera se përse dhjetra mijëra qytetarë, kryesisht të rinj, janë derdhur sot rrugëve të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë. Edhe nëse nuk do të ekzistonte afera kriminale e Zvërnecit, diçka tjetër do ta kishte pjellë protestën kolektive si nevojë e shoqërisë për t'u mos u asgjesuar.

Në pikën kur përfaqësimi me votë, si forma më e lartë e demokracisë, është asfiksuar. Kur të zgjedhurit, që do të duhej të ishin zëri i atyre që i votojnë, janë ushtarët e kryetarit që i vendos në listë apo më keq akoma të grupeve që i financojnë dhe banditëve që i përcaktojnë, padyshim që shoqëria do të kërkojë një rrugë të re për të marrë në dorë fatet e veta.

Në pikën kur taksat e qytetarëve më të varfër në Europë përdoren për të pasuruar ekskluzivisht një klan të ngushtë në pushtet, kur qindra miliona euro shkojnë për inceneratorë fantazaëm, check- up, sterilizime, koncensione e tendera, pë përfillur ata që paguajnë çdo ditë me djersën e gjakun e tyre, sigurisht që vjen një moment që njerëzit duan që një model i tillë qeverisje të çrrënjoset.

Në pikën kur pasuria publike nuk administrohet në mënyrë të ndershme, por shqyhet në copa për interesat e një njeriu të vetëm: ndahet si plaçkë për banditët e votave, për biznesmenët që financojnë fushatat apo të huajt që lobojnë për ta mbajtur në pushtet, patjetër që të zotët e kësaj pasurie do të ngrihen për ta shpëtuar atë.

Në pikën kur propaganda ka mbytur zërin qytetar, kur shoqëria nuk ka asnjë mundësi të shpalosë shqetësimet dhe të vërtetat e saj, kur në të gjitha mediat mbizotëron vetëm versioni i fjalimeve pafund të liderit- sundimtar, pikërisht mbi këtë shkretëtirë të së vërtetës, ngjizen platformat e reja të lirisë së shprehjes.

Pra është përjashtimi i qytetarëve nga të drejtat e tyre themelore që e ka sjellë vendin në krizë. Protesta që na befasoi të gjithëve nuk duhet parë thjesht si një revoltë e të papërfaqësuarve por si nevojë emergjente për një ekuilibër të ri në shoqëri. Edi Rama, i mbërthyer nga paranoja e humbjes së pushtetit, nuk mund ta kuptojë diçka të tillë. Ai zvarritet nga ditë në ditë duke shpresuar se protesta do të zbehet, se qytetarët do të qetësohen, se të vetët nuk do e braktisin e ai do t'i rikthehet sundimit si më parë.

Atë që Rama nuk e kupton, një tipar dallues ky i sundimtarëve kur u vjen fundi, duhet ta kuptojnë ata që sot janë rreshtuar pas hijes së tij. Ajo është hija e një skeleti politik. Protesta nuk do të ndalet deri sa shoqëria ta ketë gjetur ekulibrin e ri, si të vetmen zgjidhje për të mbijetuar. Sa më shumë të kapet me thonj Rama pas karrikes aq më të forta do të jenë pasojat e përplasjes me qytetarët. Sa më parë të largohet aq më e madhe do të jetë mundësia e gjetjes së paqes sociale pa trauma si ato të 30 viteve më parë.

Vetë Partia Socialiste duhet të ikë nga kthetrat e mafias dhe t'i rikthehet të majtës progresiste. Ata që nuk janë bërë pis në llumin e krimit, kanë sot mundësinë të rigjejnë veten në bulevard. Të braktisësh Ramën nuk është vetëm ndarje me të keqen, por është të shpëtosh edhe vendin nga më e keqja. Qëndrimi i tij në pushtet vetëm sa e shton trysninë e një revolte që është gati të shpërthejë.
Jo vetëm socialistët, por edhe ata që përfitimi, biznesi apo interesi i ka lidhur pas pushtetit, duhet të kuptojnë që vetëm rigjetja e një ekuilibri të ri mund të shmangë përplasjet dhe të sjellë paqen sociale. Për këtë duhet të gjejnë guximin ta bëjnë kurban Edi Ramën. Dhe pastaj të bien dakort për shestimin e kontureve të një Shqipërie të Re

STARMER U DORËHOQ! ANALIZA: PSE BRITANIA PO PËRBALLET ME NJË KRIZË TË VAZHDUESHME POLITIKE DHE ROTACION TË SHPESHTË TË KRYEMINISTRAVE?

Mbretëria e Bashkuar po kalon një periudhë të pazakontë paqëndrueshmërie politike, me ndryshime të shpeshta në krye të qeverisë dhe vështirësi në zbatimin e reformave afatgjata. Analistët krahasojnë situatën aktuale me Republikën e Katërt Franceze (1946–1958), një periudhë e karakterizuar nga qeveri jetëshkurtra dhe bllokime politike.

Që nga referendumi për Brexit në vitin 2016, Britania ka parë një seri të shpejtë liderësh në krye të qeverisë – nga David Cameron, Theresa May, Boris Johnson, Liz Truss dhe Rishi Sunak, deri te Keir Starmer.

Kjo lëvizshmëri e vazhdueshme ka sjellë edhe ndryshime të shumta në kabinet, duke penguar vazhdimësinë e politikave publike.

Ish-zyrtarë të lartë britanikë argumentojnë se rotacioni i shpeshtë i ministrave dëmton seriozisht aftësinë e shtetit për të realizuar reforma komplekse, veçanërisht në fusha si pensionet, sistemi fiskal dhe investimet strategjike.

Ekspertët ekonomikë paralajmërojnë se paqëndrueshmëria politike ka ndikuar edhe në besimin e tregjeve financiare, duke rritur kostot e huamarrjes për qeverinë britanike. Sipas tyre, pasojat u bënë veçanërisht të dukshme gjatë mandatit të shkurtër të Liz Truss.

Analiza thekson se sfidat nuk janë vetëm ekonomike, por edhe shoqërore. Ndarjet e thella mbi çështje si Brexit, politika e jashtme, dallimet mes brezave dhe polarizimi kulturor kanë fragmentuar elektoratin dhe e kanë bërë më të vështirë krijimin e një konsensusi të qëndrueshëm politik.

Historianët vërejnë se Franca arriti ta kapërcente një krizë të ngjashme me krijimin e Republikës së Pestë nën udhëheqjen e Charles de Gaulle, duke siguruar stabilitet institucional dhe aftësi më të madhe për të zbatuar politika afatgjata.

Sipas autorit të analizës, edhe Britania ka nevojë për një lidership që të ndërtojë konsensus dhe të marrë vendime strategjike të qëndrueshme, në vend që të mbetet e bllokuar në cikle të vazhdueshme krizash politike dhe ndryshimesh në krye të qeverisë.

DHJETË VJET PAS REFERENDUMIT, BREXIT I KA KUSHTUAR BRITANISË 6% TË EKONOMISË SË SAJ



Ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar ka pësuar një goditje prej rreth 6% si pasojë e Brexit-it, sipas analizës së ekonomistëve mbi të dhënat e brendshme të Bankës së Anglisë që lidhen me vendimet, qëndrimet dhe rezultatet financiare të mijëra kompanive britanike që nga referendumi i para dhjetë vjetëve.

Duke shqyrtuar të dhënat që Banka e Anglisë përdor për të vendosur normat e interesit, studimi analizoi rritjen e humbur ekonomike duke u përpjekur të rindërtonte se si do të ishte zhvilluar ekonomia britanike nëse vendi nuk do të kishte votuar për t'u larguar nga Bashkimi Evropian.

Studimi zbuloi se rreth gjysma e goditjes ekonomike erdhi nga befasia dhe pasiguria e madhe që pasoi referendumin, ndërsa pjesa tjetër u shkaktua nga rritja e barrierave tregtare pasi Mbretëria e Bashkuar doli nga bashkimi doganor dhe tregu i përbashkët në vitin 2021.

Megjithatë, disa kritikë thonë se studimi nuk merr plotësisht parasysh performancën më të mirë të sektorëve amerikanë të investimeve dhe teknologjisë, apo ndikimin e krizës energjetike evropiane që ndodhi katër vjet më parë.

Bashkautor i studimit, profesori britanik Nick Bloom nga Stanford University, tha se Mbretëria e Bashkuar po rritej me ritme të shpejta para Brexit-it dhe se, pa këtë ndërprerje, mund të kishte arritur të ndiqte të paktën pjesërisht ritmin e rritjes së SHBA-së. Ai argumentoi se të dhënat e kompanive të Bankës së Anglisë ofrojnë prova të rëndësishme mbështetëse.


PNUD HEDH ALARMIN PËR TË MOSHUARIT NË SHQIPËRI, PO TROKET KRIZA HUMANITARE

Plakja e popullsisë po ndryshon gjithnjë e më shumë strukturën sociale në Shqipëri, por ndërkohë po shëndërrohet në një krizë shendetësore dhe humanitare.

Të dhënat e Programit të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë (PNUD) në vitin 2026 tregojnë se rreth 20% e popullsisë është mbi 65 vjeç, ndërsa me rritjen e kësaj grupmoshe po shtohen edhe sfidat për kujdesin ndaj tyre.

Familja vijon të jetë mbështetja kryesore, por roli i saj po bëhet më i vështirë. Të dhënat e PNUD tregojnë se për 43-49% e të moshuarve kujdeset njëri nga bashkëshortët dhe 32-45% e pjesës tjetër kujdesen fëmijët. Megjithatë, kjo strukturë po dobësohet nga emigracioni dhe ndryshimet sociale. Burrat mbështeten kryesisht tek gratë për kujdes, ndërsa gratë e moshuara janë më të ekspozuara ndaj vetmisë dhe shpesh mbeten pa mbështetje.

Për një pjesë të konsiderueshme, mungesa e familjarëve është një problem i përditshëm. Rreth 41% e të moshuarve që kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme jetojnë larg fëmijëve ose të afërmve, çka e bën më të vështirë përballimin e nevojave bazë. Gjendja shëndetësore përbën një tjetër sfidë të madhe. Shumica e të moshuarve vuajnë nga sëmundje kronike, ku 84% kanë probleme kardiovaskulare, 76% kufizime fizike dhe 61% artrit.



Një në pesë përballet edhe me probleme të shëndetit mendor. Në të njëjtën kohë, 68% e të moshuarve me varësi të lartë nuk ndihen të sigurt në banesat e tyre. Situata rëndohet nga mungesa e transportit publik për 61% të tyre, duke kufizuar aksesin në shërbimet shëndetësore, sidomos jashtë Tiranës. Vështirësitë ekonomike mbeten një pengesë e fortë për marrjen e shërbimeve.

Rreth 13% e të moshuarve jetojnë me më pak se 10 mijë lekë në muaj, ndërsa 72% kanë të ardhura nga 10 mijë deri në 30 mijë lekë. Si pasojë, 67% deklarojnë se nuk mund të përballojnë një kujdestar privat.

Edhe shërbimet publike nuk arrijnë të plotësojnë nevojat në rritje. Qendrat rezidenciale dhe ato ditore përballen me mungesë personeli dhe nuk ofrojnë gjithmonë shërbime të nevojshme si fizioterapia apo kujdesi për demencën, ndonëse kërkesa për to është e lartë. Në këtë situatë, presioni reflektohet edhe në gjendjen emocionale të të moshuarve.

Rreth 72% e atyre me varësi të lartë raportojnë stres dhe ankth, një problem që bëhet më i theksuar tek ata që jetojnë vetëm.

Të dhënat tregojnë se plakja e popullsisë po kthehet në një sfidë të rëndësishme për politikat sociale, duke kërkuar më shumë mbështetje dhe shërbime për këtë kategori./Monitor

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE
ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ

Shpresa Programme
Inspiring hope & change

Stronger together.
Better together.
Shpresa together.

LISTENING CAMPAIGN 2026

ACROSS ALL SHPRESA PROGRAMME PROJECTS



Listening, Learning and Leading Together

We want to listen to you so we can learn together and lead together for a stronger future.

WE LISTEN to your experiences

WE LEARN from your ideas

WE LEAD together for a better future

WE GROW together as a community

QUESTIONS FOR THE LISTENING CAMPAIGN



1. What worked well for you during the past year?
2. What can we improve?
3. How would you like to be involved in this journey together?
4. What has helped you the most from Shpresa Programme?
5. What activities or support would you like to see more of?
6. What priorities should our community focus on in the future?

YOUR VOICE MATTERS!


YOUR VOICE LEADS OUR ACTIONS!

Thank you for being part of the change

www.shpresa.org | Shpresa Programme | @shpresaprogramme | info@shpresa.org

"PODCASTI, MIDIS REALITETIT DHE PROPAGANDES"

AURON TARE



Nuk e dëgjoj podkastin e Kryeministrit. As nuk më ka munduar ndonjëherë pyetja e madhe filozofike nëse një kryeministër duhet të qeverise nepermjet nje podkasti apo jo.

Prandaj, kur një mik më dërgoi një fragment nga podkasti i fundit I Kryeministrit tone, nuk ndjeva asnjë tundim ta hapja. Por miku nguli këmbë. Kështu që, e hapa dhe e degjova.

Fragmenti ishte i shkurtër. Mjaftoi, megjithatë, për të më lënë një habi të vogël. Kryeministri u shpjegonte shqiptarëve që protestojnë , pra edhe mua, se ruajtja e zonave të mbrojtura dhe trashegimise kulturore qenka lajtmotivi i qeverisë së tij dhe se ata që kritikojnë këtë politikë duhet të kenë kujdes, sepse rrezikojnë të bëhen "instrumente në duart e interesave të tjera".

Këtu u ndala.

Kam më shumë se tridhjetë vjet që merrem me trashëgiminë kulturore shqiptare. Kam pasur fatin të punoj në Butrint me disa nga mendjet më të ndritura të arkeologjisë britanike. Kam bashkëpunuar me gazetarë të nivelit të lartë ndërkombëtar në kohe te errta per Shqipërine dhe Kosovën.

Kam dhënë tetëmbëdhjetë vjet nga jeta ime, pa pagesë, për kërkimet arkeologjike nënujore me një prej ekipeve më të mira amerikane.

Kam shërbyer në UNESCO dhe kam marrë pjesë në misione që nga Afrika deri në Amerikën e Jugut.

Në gjithë këto vite kam menduar se po sherbeja për Shqipërinë. Familja dhe shkolla me edukuan me kete ide. Por tani, pas kaq dekadash, më del se mund të kem qenë i gabuar.

Sipas logjikës së re politike, njeriu mund të kalojë një jetë të tërë duke mbrojtur monumente, qytete historike, peizazhe kulturore dhe pasuri kombëtare, por një mëngjes të zgjohet dhe të mësojë se paska qenë vegël e interesave të padukshme.

Kjo është një arritje e rëndësishme e mendimit bashkëkohor shqiptar. Të gjithë ne që kemi humbur vite duke besuar se mbronim Shqipërinë, paskemi nevojë për një shpjegim më të qartë se interesat e kujt kemi mbrojtur në të vërtetë.

Kur luftonim për Butrintin, interesat e kujt mbronim?

Kur krijohej Parku Kombëtar i Butrintit, për kë punonim?

Kur kërkimet arkeologjike nënujore e vendosnin Shqipërinë në hartën botërore të kësaj disipline, kujt po i shërbenim?

Kur ekipi ku bëja pjesë solli prova që rrëzonin një padrejtësi historike ndaj Shqipërisë në çështjen e Kanalit të Korfuzit, në interes të kujt ishte ai mund?

Do të isha mirënjohës po të më sqarohej.

I menduar nga kjo dilemë e re kryeministrore , ktheva makinën nga rruga e gjarperueshe e Vjosës dhe hyra në Përmet.

Doja te beja disa fotografi nga vepra e fundit e Qeverise se Kryeministrit ne dobi te trashegimise kulturore, zonave te mbrojtura dhe turizmit. Foto qe flasin sado pak per realitetin i cili rri perkundruall propagandes se podcastit .

Ndalova Makinen perballe një ndërtesë të re, Qendra e Informacioni Turistik. Një godinë e rëndë prej betoni, vendosur me një "elegancë të rrallë urbanistike" mu në oborrin e shkollës së mesme "Sami Frashëri", vetëm pak hapa larg Gurit të Qytetit, simbolit natyror të Përmetit.

Përmeti, për dijeninë e lexuesit, është ndoshta qyteti i vetëm në Evropë që rrezikon të ketë më shumë qendra informacioni sesa turistë që kërkojnë informacion.

Ka nje qender informacioni në hyrje, nje në dalje, nje në qendër dhe nja dy te tjera pergjate Vjoses ku te vetmit vizitore jane gomeret e fshatit qe kerkojne hije. Por Qeveria e Kryeminstrit tone , mendoi se qyteti nuk mund të jetonte edhe pa një tjetër Qender Informacioni. E kjo e reja eshte rende e madhe dhe e vendosur jo do kudo, po ne fund te qytetit dhe pikërisht në oborrin e shkollës, 5 metra nga Monumenti natyror I Gurit te Permetit.

Kështu, fëmijëve iu mor një pjesë e hapësirës ku luanin, që të ndërtohej një godinë e kushtueshme, e cila sot rri bosh me një dinjitet monumental.

Në epokën kur çdo turist mban në xhep më shumë informacion sesa mund të mbajë një qendër turistike me dy kate, ne vazhdojmë të ndërtojmë godina për informacionin.

Dhe këtu më lind një pyetje e thjeshtë. Ata qytetarë të Përmetit që e shohin këtë ndërtesë dhe tundin kokën duke protestuar ne heshtje interesat e kujt po mbrojnë?

Ka pyetur valle Kryeminstri ne se ne cilin vend te Afrikes Ministrja e Arsimit ju mer femije oborrin e shkolles per te ndertuar budallallekun e rradhes?

Ata prindër që pyesin pse fëmijëve u është zvogëluar oborri i shkollës, në shërbim të kujt janë?

Po Ata banorë që habiten se si ndërtohet pranë një zone të mbrojtur një objekt pa funksion të dukshëm, cilës fuqi të errët po i binden?

Ndoshta edhe ata janë instrumente. Ndoshta, por në Shqipërinë e sotme duket se qytetari që pyet është gjithmonë i dyshimtë, ndërsa ata qe ngrejne Godina betoni pa arsye jane patriot?

Gjithsesi kush lexon le të gjykojë midis realitetit dhe propagandës për të kuptuar se përse rinia ka mbushur bulevardin pikërisht për të ndryshuar këtë realit. Realitet I cili nuk fshihet dot më pas një Podcasti plot ngjyra



NJË ANTIHERO I DËSHPËRUAR I HOMERIT

Kryeministri ka përdorur mitin antik të Odiseut që nuk joshet nga sirenat, për të përçuar mesazhin se ai do të vazhdojë përpara pa pyetur për protestuesit. Por nëse nuk do e kish njohur veprën e Homerit vetëm përmes ekranizimit, do të kish gjetur tek kjo metaforë gjurmët e një autokrati

ANDI BUSHATI



Kur formimin kulturor e ke me të dëgjuar, përdorimi i këtij bagazhi rrezikon të prodhojë efektin e kundërt. Në një përpjekje të dështuar për të krijuar diferencën me blogerët, të rinjtë pa formim politik dhe ndjekësit e rrjeteve sociale që po protestojnë masivisht kundër tij, Edi Rama ka marrë një shëmbull nga vepra më e vjetër e letërsisë botërore, Odiseja e Homerit, për të dhënë mesazhin se nuk ka ndërmend të dorëzohet.

Para deputetëve socialistë, që e ndiqnin si të shushatur, ai e krahasoi veten me heroin e antikitetit, që pranoi të lidhej me litarë pas direkut të anijes, për të mos rënë pre-, ashtu sikurse ia pati lexuar fatin Çircja-, e sirenave që kërkonin t'ia pengonin udhëtimin drejt Itakës.

Lideri i rilindasve e zgjodhi këtë metaforë për tu dhënë të tijëve mesazhin, se as «zhurma e rrugës», as «fuqia e algoritmeve», as shtypi botëror që po e përdor Shqipërinë si një laborator në betejën kundër familjes Trump, nuk do ta pengonin të ndiqte qëllimin e tij, modernizimin dhe zhvillimin e vendit dhe përfundimin në stacionin e fundit, atë të BE.

Në fakt, në literaturën e sotme politike shembulli mitologjik i mostundimit ndaj sirenave ka simbolikën e një udhëheqësi modern që nuk e ndal asgjë para objektivave strategjike. Atë nuk e pengojnë të vazhdojë drejt Itakës së vet, as joshja nga idetë populiste, as kompromiset për hir të karriges, as aleancat me bindje që nuk janë të tijat, madje as frika e rrëzimit nga pushteti.

Por, kush e njeh me themel këtë literaturë është i ndërgjegjshëm edhe për përdorimin në sens të kundërt të kësaj metafore.

Ashtu siç përdoret për të vizatuar një politikan që nuk bën kompromis me parimet, ajo merret si shembull edhe për një të ndryshëm, që i ka veshët të shurdhër dhe sytë të mbyllur për të dëgjuar, kuptuar dhe pranuar sentimentin e popullit të vet.

Tek udhëtimi i Odisesë, Homeri -, nëse ai ka ekzistuar vërtet dhe nuk është thjeshtë sendërzim i një trashigimie të tërë - rrefen se ekuipazhit të anijes iu zunë veshët me dyllë, që rremëtarët të mos tundoheshin prej sirenave. Kjo fabul në modernitet shpesh ka shërbyer edhe për të shpjeguar një gjendje autokratike.

Sirenat, jo domosdoshmërisht simbolizojnë joshjen dhe tundimin që të shmang nga rruga e drejtë. Ato mund të jenë edhe sendërzim i të gjitha kundërpushteteve si opozita, media, qytetarët e pakënaqur, etj. Në këtë rast, Odiseu i ditëve mjnd të shihet edhe si një prijës veshëdyllosur ndaj brengave të njerëzve të tij. Ai më shumë i përngjan një personazhi tjetër homerik, ciklopit Polifem, me një sy të vetëm, pra dikujt që kufizohet tek një këndvështrim për ngjarjet dhe botën.

Po ashtu, as Itaka, në ditët e sotme nuk simbolizon vetëm arritjen e një qëllimi detyrimisht ta lartë. Ajo mund të barabitet dhe me etjen për pushtet, mbajtjen me çdo kusht të tij dhe shkaktimin e përplasjeve traumatike me këdo që nuk i bindet këtij objektivi.

Ky version i rilexuar i mitologjisë e sheh Odiseun si një personazh që shkel mbi gjithçka për të arritur atë që kërkon sipas parimit "qëllimi justifikon mjetin". Ky lloj heroi ndërsa lundron drejt Itakës është krejtësisht jashtë realitetit, i mbushur me veten dhe i paaftë të dëgjojë të tjerët, ndonëse ai mund të vetëndihet si një largpamës qëllimirë.

Edi Rama, i cili me siguri, e njeh Odisenë vetëm përmes rolit të Bekim Fehmiut, që ka parë kur ka qenë i vogël, nuk ka pasur djeni për këtë version të transformuar të mitit të tij. Përndryshe nuk do kishte rimarë pikërisht këtë metaforë në momentin e tanishëm. Pasi ajo i shkon fiks për shtat, një njeriu që e ka humbur sensin e realitetit, që i ka dyllosur veshët, që e ka shndërruar pushtetin jo në mjet, por në qëllim në vetvete.

Në vend që të reket të kuptojë frustrimin, pakënaqësinë dhe revoltën e atyre që janë në rrugë, ai po gënjen të tijët dhe veten, duke i parë ata si vegla të një instrumentalizimi më të madh: herë si agjentë të grekëve, herë si të iranianëve; herë si të gënjyer nga fuqia e algoritmeve e herë si viktima të mediave më prestigjoze të botës, që i yshtin protestuesit të bëhen aktorë të një beteje që nuk është e tyrja.

Pikërisht mbështetja tek i vtemi mit që njeh, ai i Odisësë të ekranizuar, e ka shtyrë Edi Ramën të çirrej këtë fundjavë se ai do të lundrojë drejt Itakës së vet, pa dëgjuar inskenimet e "sheshit të xhirimit" dhe atyre që luajnë rol të paracaktuar poshtë zyrës së tij dhe pa iu nënshtruar "zhurmës së turmave". Eshtë pikërisht kjo gjë që e ka yshtur drejt një tirade të re përçmimesh dhe fyerjesh ndaj atyre që protestojnë. Por kaq gjë, fundja fundit, ata mund ti'a falin, ndonëse edhe për një pjesë prej tyre injoranca nuk përbën argument.

NUK ISHTE ALGORITMI QË SHKAKTOI ZEMËRIMIN, POR ZEMËRIMI QË TEJKALOI ALGORITMIN

GJERGJ EREBARA

Nëse mundet që bota e stërmadhe e medias sociale të përshkruhet me pak fjalë, është pak a shumë kjo: media e tipit "Facebook" apo "Instagram", të cilat përdoren më shumë nga shqiptarët e moshës së re e të mesme, përpiqen t'i mbajnë njerëzit në lundrim sa më gjatë, duke u dhënë atyre informacionin që "Facebook" supozon se po kërkojnë, supozime të mbështetura në informacionin e mbledhur nga sjellja e përdoruesit.

Ky model biznesi ka bërë që "Facebook" të fitojë përmbajtje të ofruar falas nga përdoruesit, kryesisht përmes llogarive personale dhe ta shesë vëmendjen e tërhequr të publikut nga ky informacion, te reklamuesit që reklamojnë kryesisht nga faqet.

"Facebook" dhe "Instagram" duket se përdorin një kombinim të luhatshëm të interesit që kanë për përmbajtje që përdoruesit ia japin falas dhe interesit që kanë për shitjen e reklamave, për të caktuar vizibilitetin e secilit postim.

Postimet për të cilat përdoruesit e tjerë shprehin interes, u shfaqen më shumë njerëzve. Postimet për të cilat nuk shfaqin interes, do të duhet që postuesi të paguajë reklama që të mund t'i shpërndahet mesazhi. Reklamat funksionojnë nga ana e tyre në formë burse. Nëse ka shumë kërkesë për reklama, siç ndodh në fushata zgjedhore në Shqipëri, çmimi rritet. Rrjedhimisht, kur je biznes i vogël që dëshiron të reklamosh diçka në kohë zgjedhjesh në Shqipëri, mund të vëresh se si kostoja për të arritur disa blerës potencialë dyfishohet apo trefishohet për shkak se lumi i parave të fushatës praktikisht të nxjerr jashtë tregut.



Grupe të ndryshme, fjala vjen, qeveritë, përdorin sjellje të koordinuar për të gënjyer algoritmin sikur një postim i caktuar përbën interes të lartë. Siç është vërejtur nga së paku një hetim në SHBA, "Facebook" nuk ka ndonjë shqetësim të madh nga kjo sjellje e koordinuar, megjithëse zyrtarisht e konsideron të parregullt. Arsyeja është se sjellja, e koordinuar apo tjetër, i shërben "Facebook" që të mbajë në linjë më shumë përdorues dhe për një kohë më të gjatë.

Ata që kanë shumë burime në dispozicion, si, fjala vjen, Kryeministri Edi Rama, përpiqen të dominojnë dhe në shumë raste ia dalin të domonojnë median sociale përmes një fenomeni që ekspertët e njohin si saturizim. Ndërsa një kritik i qeverisë mund të bëjë një postim, qeveria ka ushtri të tëra me propagandistë që janë në gjendje të prodhojnë një volum të stërmadh materialesh, të cilat, duke pasur cilësi grafike më të lartë dhe duke shfrytëzuar burime financiare të stërmëdha, arrijnë të dominojnë median sociale duke lënë zërat kritikë të izoluar nëpër oborre të ngushta.

Metodat që "Facebook" dhe rrjete të tjera sociale përdorin për të mbajtur përdoruesit, individë apo reklamues, të varur prej vetes, janë përshkruar nga ekspertët si metoda të huazuara nga industria e bixhozit dhe kanë ngritur shqetësime se kanë krijuar varësi te njerëzit. Në industrinë e bixhozit, njësia matëse e suksesit nuk është sa para ka shpenzuar kumarxhiu në kazino, por sa orë ka kaluar duke luajtur. Kohëzgjatja e shpenzuar në lojë është treguesi i suksesit. Paratë e fituara janë rrjedhojë e kësaj dhe jo objektivi primar. E njëjta gjë ndodh me "Facebook", interesi i së cilës është të mbajë njerëzit sa më gjatë në platformë. Algoritmet kanë krijuar "ishuj" apo "oborre të brendshme", në të cilat grupe të caktuara përdoruesish ndërveprojnë me njëritjetrin, ndërsa algoritmi mënjanon çfarëdolloj informacioni për të cilin grupi nuk ka shprehur interes. Kjo është mënyra se si "Facebook" ka funksionuar tashmë prej vitesh, duke krijuar "dhoma të jehonave" (echo chamber) apo grupe të izoluara njerëzish, të cilët rrotullohen me njëritjetrin pa parë më tutje.


Por më 31 maj, ky sistem duket se u thye. Orteku i reagimeve të qytetarëve ndaj ngjarjes së shëmtuar të dhunimit dhe rrëmbimit të një qytetari nga rojat private të sigurisë në Zvërnec ishte origjina e gjithë kësaj. Nëse e mbani mend, ngjarja në Zvërnec ndodhi më 30 maj, ditë e shtunë, dhe deri të dielën, kur disa qytetarë në Tiranë thirrën një protestë ku morën pjesë mijëra veta, algoritmi i "Facebook" u trondit, jo se pati ndonjë komplot, jo se pati ndonjë "luftë hibride", por për shkak se, për fatin e keq të qeverisë, qytetarët u zemëruan në atë masë sa reagimi në rrjetet sociale theu muret e oborreve tradicionale, kapërceu ishujt e izolimit apo dhomat e jehonës dhe u derdh në bulevardin "Dëshmorët e Kombit".

Ndërsa media tradicionale heshti, qytetarët vunë re fytyrën e oligarkisë: kontroll i sferës mediatike tradicionale përmes injorimit të lajmit të vërtetë dhe bombardimit me emisione spektakli dhe saturimit të medias sociale nga qeveria.

Zemërimi i qytetarëve natyrisht që nuk u krijua në mënyrë artificiale as nga algoritmi dhe as nga ndonjë informacion i rremë. Zemërimi qytetar thjesht sa arriti pikën e shpërthimit me ngjarjen në Zvërnec. Ishte zemërimi, ai që theu algoritmin dhe jo algoritmi ai që shkaktoi zemërimin. /BIRN/

Dotech website

NO WEBSITE?
NO CUSTOMERS



Akoma nuk keni një website ? !!

Akoma nuk jeni regjistruar në Google ? !!

Suksesi fillon nga nje website profesionale ✍️

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

ADRESA E ZYRAVE:

30 Avenons Road,
London, E13 8HT

NE MUND T'IU NDIHMOJME EDHE ME:

- Business Cards
- Logos
- Posters
- Banners

WEBSITES THAT GROW YOUR BUSINESS

MODERN SECURE RESPONSIVE

RANK HIGHER GET FOUND GET MORE CLIENTS

SUPPORT YOU CAN COUNT ON

INVESTO SOT, FITO NESËR!

NJË WEBSITE PROFESIONALE ËSHTË HAPI I PARË DREJT SUKSESIT TËND.

RAPORTI SHOKUES: VETËM NJË QYTET NË EUROPË ËSHTË MË I SHTRENJTË SE TIRANA

Ndërsa inflacioni dhe rritja e kostos së jetesës vazhdojnë të ushtrojnë presion mbi buxhetet familjare në të gjithë Europën, përballueshmëria është bërë një nga çështjet ekonomike përcaktuese për qytetarin mesatar europian.

Tirana është renditur në qytetin e dytë më të shtrenjtë në Europë, teksa një familje, me katër persona me dy të rritur me rrogë mesatare shpenzon 89% të të ardhurave për të bërë një jetesë normale.

Në këto nivele, Tirana renditet vetëm pas Lisbonës, që kryeson lisën në Europë me një nivel prej 12195.8%.

Të dhënat u bënë të ditura në një raport të fundit të Tradingpedia. Për të zbuluar se cilat kryeqytete ofrojnë standardin më të mirë të jetesës me barrën më të vogël financiare në raport me të ardhurat mujore, Tradingpedia krahasoi të dhëna nga 37 kryeqytete evropiane, duke marrë parasysh shpenzimet e përditshme dhe pagat mesatare neto mujore (paga "reale" pasi zbriten të gjitha taksat dhe detyrimet nga paga bruto). Informacioni për Shqipërinë është përpunuar nga Monitor.

Raporti merr në konsideratë pagën neto, që për Shqipërinë është 760 euro në muaj dhe të ardhurat e familjes i llogarit në 1520 euro në muaj, duke supozuar që punojnë dy të rritur. Një shpenzim për një familje me katër persona llogaritet në 1353 euro në muaj, për të cilin duhen shpenzuar gati 90% e të ardhurave.

Shqipëria ka një kosto jetese shumë më të shtrenjtë sesa vendet e tjera të rajonit. Në Shkup Të Maqedonisë së Veriut, ku paga mesatare neto është në nivele të ngjashme më të Shqipëri, në 769 euro në muaj, shpenzimet mujore për një familje me 4 persona janë 1037 euro, duke zënë 67% të të ardhurave, shumë më pak sesa në Shqipëri.

Në Beograd, ku paga neto është 1081 euro, pesha është 68.2%, teksa shpenzimet mujore janë pak më të larta se në Tiranë duke arritur në 1478 euro, por pagat neto janë rreth 30% më të larta.

Në Podgoricë, paga mesatare mujore neto është 883 euro, më e lartë sesa në Shqipëri dhe shpenzimet mujore janë më të ulëta në 1077 euro, duke bërë që Sarajeva të jetë relativisht qyteti me koston më të ulët të jetesës në rajon, në raport me të ardhurat.

Të dhënat për Kosovën nuk janë në këtë raport.

Qyteti më i lirë për të jetuar është Brukseli, ku paga mesatare neto mujore për një person është 2945 euro, ndërsa shpenzimet mujore janë 2653 euro, ose 45% të të ardhurave.


Raporti

Raporti ofron një analizë të detajuar të shpenzimeve bazë, përfshirë strehimin, ushqimin, transportin, kujdesin personal dhe argëtimin, për të dhënë një pasqyrë të qartë të përballueshmërisë në të gjithë kontinentin.

Sipas të dhënave më të fundit mbi kostot e jetesës dhe pagat në 37 kryeqytete evropiane, Lisbona është bërë shembulli më i qartë i përkeqësimit të krizës së përballueshmërisë së banesave në Europë. Në Lisbonë, qiraja mesatare mujore për një apartament me një dhomë gjumi në qendër të qytetit tani është 1,331.48 euro, ndërsa paga mesatare neto është vetëm pak më e lartë, 1,342.83 euro.

Kjo do të thotë se qiramarrësit shpenzojnë praktikisht 99.15% të të ardhurave të tyre mujore vetëm për strehim, duke u lënë mesatarisht vetëm 11 euro pasi paguhet qiraja.

Presioni nuk kufizohet vetëm në Portugali. Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, renditet si qyteti i dytë më pak i përballueshëm në listën tonë sipas raportit qira-pagë, me qiratë që konsumojnë më shumë se 93% të pagave lokale.



Në Kiev, pavarësisht çmimeve dukshëm më të ulëta të qirave në terma absolutë, pagat mbeten aq të ulëta në raport me kostot e strehimit, sa banorët ende shpenzojnë gati 88% të të ardhurave të tyre për qira.

Porto, Milano dhe Malaga gjithashtu dallohen ndër tregjet më të rënduara të qirave në Evropë. Në Porto, qiramarrësit shpenzojnë mbi 85% të pagës së tyre për qira, ndërsa Milano dhe Malaga kërkojnë afërsisht tre të katërtat e të ardhurave mujore për banesa të vendosura në qendër.

Duket se problemet e përballueshmërisë nuk kufizohen më vetëm te kryeqytetet tradicionale financiare të Evropës; ato tani prekin edhe qytetet e mesme dhe destinacionet me turizëm të lartë.

Europa Jugore duket veçanërisht e ekspozuar. Krahas vendeve të përmendura më sipër, qytetet spanjolle dhe italiane dominojnë pjesën e sipërme të renditjes së përballueshmërisë, me Barcelonën, Valencian, Napolin dhe Romën që kërkojnë të gjitha midis 60% dhe 70% të pagave mesatare neto për qira.

Në shumë prej këtyre qyteteve, kërkesa turistike, rritja e qirave afatshkurtra dhe oferta e kufizuar e banesave vazhdojnë t'i shtyjnë çmimet përtej asaj që të ardhurat lokale mund të përballojnë realisht.

Ku qiramarrësit kursejnë pjesën më të madhe të pagave të tyre

Në skajin tjetër të spektrit, disa qytete të Europës Qendrore dhe Veriore mbeten relativisht të përballueshme, pasi merren parasysh pagat lokale. Gjermania duket veçanërisht e përballueshme, me qytete si Essen, Mannheim, Nuremberg dhe Dresden, ku banorët mund të kursejnë midis 76% dhe 81% të pagës së tyre pasi paguajnë qiranë.

Essen renditet si tregu më i përballueshëm i qirave në Europë në listën tonë. Dikur i njohur si zemra industriale e Gjermanisë, ai tani është një nga qytetet më të gjelbra në Evropë, gjë që, së bashku me koston më të ulët të jetesës krahasuar me qytete si Munich ose Frankfurt, e bën atë një vend ideal për një jetë të përballueshme në Evropën Perëndimore.

Qiraja mesatare për një apartament në qendër të qytetit është vetëm 551.56 euro, që përfaqëson vetëm 18.9% të pagave mujore lokale.

Në vendin e dytë renditet Mannheim, i cili, përveçse është një qendër industriale dhe tregtare, është edhe një qytet universitar që strehon University of Mannheim. Këtu, qiramarrësit, përfshirë shumë studentë, shpenzojnë mesatarisht 804 euro në muaj ose rreth një të pestën e të ardhurave tipike lokale për strehim.

Qytetet zvicerane gjithashtu dallohen në renditje si vende të favorshme për të marrë banesë me qira bazuar në pagat lokale, pavarësisht se kanë disa nga qiratë më të larta në Europë. Në Zurich, një apartament mesatar kushton më shumë se 2,600 euro në muaj — shifra më e lartë ndër 127 qytetet e analizuara — por pagat jashtëzakonisht të larta (7,424.32 euro neto në muaj) bëjnë që banorëve t'u mbeten ende pothuajse 65% e të ardhurave pas pagesës së qirasë.

Edhe Basel, Bern dhe Lausanne shfaqin qira të larta, por për sa i përket raportit qira-të ardhura, ato janë edhe më të përballueshme. Prania e fortë e Zvicrës në këtë renditje tregon se rritja e pagave mbetet një nga mbrojtjet më të forta kundër presionit të kostove të strehimit dhe çmimeve.

Qytetet nordike vazhdojnë gjithashtu të tregojnë stabilitet relativ. Në Copenhagen, Aarhus, Oslo dhe Bergen, qiratë mbeten të larta në vlerë absolute, por balancohen nga të ardhura më të larta dhe raporte më të ulëta qira-të ardhura sesa në shumë qytete të Evropës Jugore. /monitor

FOX NEWS: PROTESTUESIT SHQIPTARË I MBUSHIN RRUGËT DUKE KËRKUAR DORËHEQJEN E KRYEMINISTRIT MES AKUZAVE PËR KORRUPSION

Qeveria e kryeministrit socialist, Edi Rama, po përballet me presion në rritje, ndërsa protestat kundër saj vazhdojnë. Sipas një artikulli të publikuar nga media amerikane Fox News, demonstruesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës, por edhe të kreut të opozitës, Sali Berisha, duke i konsideruar të dy kampet politike përgjegjëse për korrupsionin e akumuluar gjatë më shumë se tre dekadave pas rënies së komunizmit.

Sipas raportimit, një nga arsyet që ka nxitur zemërimin qytetar është plani për ndërtimin e dy resorteve luksoze në bregdetin shqiptar nga investitorë të lidhur me biznesmenin amerikan Jared Kushner. Projekti, me vlerë disa miliarda dollarë, parashikon krijimin e rreth 10 mijë dhomave hoteli dhe vilave turistike në ishullin e Sazanit dhe në zonën e Zvërnecit.

Një prej lokacioneve të planifikuara është ishulli i Sazanit, ku ndodhet një ish-bazë ushtarake sovjetike, ndërsa projekti në Zvërnec ka ngjallur debate për shkak të afërsisë me peizazhin e mbrojtur Vjosë-Nartë, habitat i flamingove, fokave mesdhetare dhe breshkave të detit.

Ish-ambasadori shqiptar në SHBA dhe OKB, Agim Nesho, deklaroi për Fox News se protestat nuk janë kundër familjes së presidentit amerikan apo investitorëve të huaj.

"Investitorët po sjellin rreth 4 miliardë dollarë në Shqipëri, duke krijuar vende pune dhe mundësi për të rinjtë. Problemi nuk janë investitorët, por mënyra se si është menaxhuar vendi nga qeveria aktuale", tha Nesho.

Ai gjithashtu pretendoi se zgjedhjet parlamentare të vitit të kaluar nuk janë njohur nga Shtetet e Bashkuara dhe se qeveria e Ramës ka fituar një shumicë që i mundëson ndryshime ligjore dhe kushtetuese.



Ndërkohë, gazetari Eric Czuleger, i cili jeton prej pesë vitesh në Shqipëri dhe ka ndjekur nga afër protestat, tha se qeveria fillimisht minimizoi numrin e protestuesve dhe më pas i cilësoi demonstratat si pjesë e një "lufte hibride" të nxitur nga aktorë të huaj.

Qeveria shqiptare ka mbrojtur projektet turistike, duke theksuar se ishulli i Sazanit mbetet pronë shtetërore dhe nuk do të shitet, ndërsa toka në Zvërnec është në pronësi private.

Në një reagim për Fox News, qeveria deklaroi se 'projektet do t'i nënshtrohen një vlerësimi të thelluar të ndikimit në mjedis dhe mohoi pretendimet se statusi i zonave të mbrojtura është hequr për t'i hapur rrugë investimeve'.

Megjithatë, sipas raportimit, Parlamenti Europian ka kërkuar së fundmi ndalimin e ndërtimeve në zonat e mbrojtura në Shqipëri dhe vendosjen e një moratoriumi për lejet e reja të ndërtimit në këto territore.

Nga ana tjetër, Asher Abehsera, një nga drejtuesit e projektit në Sazan, deklaroi se synimi është krijimi i një destinacioni turistik të standardeve ndërkombëtare, me fokus te mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi ekonomik afatgjatë.

Ndërsa protestat vazhdojnë, organizatorët dhe pjesëmarrësit shprehen se kërkesa kryesore mbetet largimi i qeverisë aktuale dhe organizimi i zgjedhjeve të reja.

Aktori dhe artisti shqiptar Florjan Binaj i cilësoi protestat si "më të mëdhatë që ka parë Shqipëria që nga viti 1991", duke theksuar se do të vazhdojë të marrë pjesë në to.

Sipas protestuesve të cituar nga Fox News, korrupsioni i lartë dhe mungesa e llogaridhënies politike janë arsyet kryesore të pakënaqësisë qytetare, ndërsa ata kërkojnë dorëheqjen e qeverisë dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme nën monitorim ndërkombëtar.

ÇFARË PO E MBAN GJALLË PROTESTËN NË SHQIPËRI, SIPAS STUDIUESVE?

Rezistenca prej më shumë se 20 ditësh e ka shndërruar "revolucionin flamingo" në një nga lëvizjet më të mëdha qytetare në Shqipëri që nga rënia e sistemit komunist. Pakënaqësi të mbartura prej vitesh po artikulohen publikisht, duke refuzuar të përfaqësohen nga politika tradicionale.

Tri javë rezistencë

Rezistenca e protestës nuk mund të shpjegohet vetëm me ngjarjet e javëve të fundit. Për akademikun Artan Fuga, ajo është produkt i një pakënaqësie që është ndërtuar prej vitesh jashtë institucioneve dhe politikës tradicionale.

"Protesta lexohet si një shpërthim i papritur zemërimi vetëm për ata që kanë zgjedhur të injorojnë atë që prej vitesh artikulohej në rrjetet sociale" – thotë ai për Deutsche Welle, duke shtuar se "në 5 – 6 vitet e fundit, pakënaqësia e shprehur në rrjetet sociale ka qenë e jashtëzakonshme".

Sipas Fugës, kritika është forcuar vazhdimisht ndaj politikave qeveritare, kryeministrit dhe opozitës. Në thelb, argumenton ai, është konsoliduar bindja se "pozita dhe opozita janë e njëjta gjë, pjesë e një establishmenti të përbashkët" që vazhdon të dominojë jetën politike shqiptare prej dekadash.

Boll me klasën e vjetër politike

Sipas politologut Blendi Kajsiu në shesh po bashkëjetojnë kauza dhe ide që shpesh gjenden në anë të kundërta të spektrit politik. Sipas tij, ajo që i bashkon protestuesit nuk është më ideologjia, por refuzimi i modelit politik.

"Jemi dëshmitarë të një krize të thellë të modelit demokratik shqiptar" – argumenton Kajsiu për Deutsche Welle. Protestuesit nuk po kundërshtojnë vetëm qeverinë, por një sistem që ka privatizuar pushtetin dhe përfaqësimin politik.

"Askush nuk është dakord me modelin e demokracisë private që ka ndërtuar Ramadhe Berisha" – thotë ai, dhe shton se narrativa kryesore e protestës është "boll me klasën e vjetër politike".

Akademiku Artan Fuga thotë se në shoqerine shqiptare ka ndodhur ajo qe sociologjia perendimore e ka shpjeguar prej dekadash, se "nese rrotacioni politik nuk freskon elitat politike, në një dite të caktuar ato elita ndodhen përpara revoltës dhe presionit te rrugës". Sipas tij, një pjesë e opinionit publik arriti në përfundimin se ndryshimi politik ishte bërë pothuajse i pamundur, me mazhorancën që mbështetet në një sistem që favorizon partinë në pushtet dhe opozitën e përfshirë në kriza të brendshme, pa një alternativë bindëse.

Zvërneci, simbol i modelit politik

Pamjet kur në rërën e Zvërnecit, para kamerave të telefonave dhe në prani të policisë së shtetit, tërhiqej zvarrë nga punonjës të sigurisë private një protestues, u shpërndanë me shpejtësi në rrjetet sociale. Revolta shpërtheu.

Për akademikun Artan Fuga, ajo skenë shpjegon pse një protestë për mbrojtjen e natyrës u shndërrua në diçka shumë më të madhe.

"Ishte një element shokues, rrënqethës për opinionin publik shqiptar" – thotë ai.



"Ngjarja nxori në pah raportin e qytetarit me shtetin, të individit me të drejtat e tij dhe përplasjen mes interesit privat dhe të drejtës publike", shton Fuga.

Këto, sipas tij janë çështje themelore në shoqërinë shqiptare, për të cilat prej kohësh janë shfaqur pakënaqësi të mëdha.,

Politologu Blendi Kajsiu thotë se hapësira publike nuk përfshin vetëm territorin, por edhe institucionet, shtetin dhe partitë politike.

Në këtë kontekst, gardhi i ngritur në Zvërnec "është një manifestim fizik i rrethimit të institucionit të kryeministrisë, të parlamentit dhe të partive politike nga 'pronarët' e tyre" – shprehet Kajsiu. Ai e sheh protestën si një reagim qytetar për të zgjeruar hapësirën publike kundër ngushtimit të saj nga interesa të ngushta private.

Gen Z nuk pret "shpëtimtarë"

Fakti që protesta nuk ka një drejtues nuk është rastësi për politologun Kajsiu. Ai e lexon si pasojë të mosbesimit ndaj lidershipit politik dhe të frikës se çdo figurë e re mund të riprodhojë të njëjtat modele që protestuesit po kundërshtojnë.

"Lëvizja është shumë pluraliste nga pikëpamja ideologjike, sociale dhe politike, për pasojë është e vështirë të prodhojë një lidership përfaqësues për të gjitha fraksionet që e përbëjnë atë" – shton ai.

Për akademikun Artan Fuga kjo protestë zhvillohet në një Shqipëri shumë ndryshe nga ajo e viteve të tranzicionit. Sipas tij, emigracioni ka sjellë një transformim të thellë kulturor dhe qytetar, veçanërisht tek brezat e rinj.

"Edhe pse nuk është më simboli 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa', përmbajtja është ajo" – argumenton Fuga.

Përmes familjarëve, emigracionit dhe kontakteve të përditshme me Perëndimin, qytetarët kanë krijuar pritshmëri të reja për mënyrën se si duhet të funksionojë shteti, drejtësia dhe raporti i individit me pushtetin.

E ardhmja e protestës?

Për politologun Blendi Kajsiu, sfida e vërtetë e protestës nis aty ku mbaron revolta.

"Protesta qytetare duhet të fillojë ndërtimin e strukturave demokratike dhe pjesëmarrëse që do të kanalizojnë dhe institucionalizojnë kërkesat e saj politike dhe demokratike" – shprehet Kajsiu.

Për Fugën, beteja e momentit është një "lojë nervash" mes protestës që kërkon të zgjerohet dhe të ruajë vrullin e saj, dhe pushtetit që nuk jep shenja se do të tërhiqet. Sipas tij, ka një hendek të madh mes qytetarëve dhe klasës politike.

"Elektorati shqiptar urban dhe sidomos të rinjtë, janë më lart në kulturë politike dhe ndërgjegje qytetare sesa klasa aktuale politike" – thotë Fuga, duke shtuar se sistemi politik shqiptar ka hyrë në një krizë të thellë që do të vijojë edhe përtej protestës.

(DW)

WASHINGTON POST: "GJENERATA Z" PO E MPOSHT RAMËN NË PIKËN MË TË FORTË, NË KOMUNIKIM

Kryeministri socialist i Shqipërisë, Edi Rama – i cili po përballet me një lëvizje proteste kundër sundimit të tij, e cila mori vëmendje globale kryesisht sepse përfshin marrëveshjet e biznesit të familjes Trump - është padyshim udhëheqësi më i fokusuar estetikisht dhe më i vetëdijshëm për imazhin në botë.

Qoftë duke veshur atlete të përditshme në samitet e NATO-s apo duke i kthyer panelet e konferencave në skena për komedi virale stand-up, 61-vjeçari Rama dinte si të tërhiqte vëmendjen e medias që përpara se influencerat të bëheshin diçka e zakonshme – dhe të rriste pushtetin nga të qenit një komunikues efektiv, megjithëse bullizues.

Prandaj, duket krejtësisht e përshtatshme që sfida më e madhe ndaj sundimit 13-vjeçar të Ramës ka ardhur nga protestuesit e zgjuar dhe të sigurt të Gjeneratës Z, të cilët, duke përdorur meme të hiperprodhuara nga inteligjenca artificiale si armët e tyre estetike, kanë përmbysur në mënyrë efektive talentet e shumta të kryeministrit - duke e ulur atë në territorin e "bumerëve të mirëfilltë".

Një artist dhe piktor me profesion, Rama u ngrit në pushtet në fillim të viteve 2000 si kryetar bashkie i kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës, duke kultivuar imazhin e një "anti-politikani" eksentrik, duke u bërtitur burokratëve dembelë para kamerave të medias dhe duke rehabilituar fasadat komuniste të rrënuara të qytetit me vizatime shumëngjyrëshe. Ai promovoi një filozofi se arti në hapësirat publike mund të nxisë transformimin e komunitetit.

Si kryeministër, Rama i ka kushtuar shumë vëmendje transformimit jo vetëm të Tiranës, dikur të zymtë, por edhe të bregdetit mesdhetar të Shqipërisë. Rrokaqiejt vezullues, vendpushimet luksoze dhe hapësirat publike të modernizuara dhe të rigjallëruara e kanë shndërruar një nga vendet më të varfra të Evropës në një pikë turistike, duke tërhequr gjithashtu vëmendjen e arkitektëve dhe artistëve më të shquar në botë.

Të rinjtë e Shqipërisë kanë qenë më pak të impresionuar nga piktori i shndërruar në politikan. Por përbuzja e tyre ishte më e dukshme në statistikat e emigracionit sesa te protestat në rrugë. Deri më tani. Ngjashëm me mënyrën se si "Pranvera Arabe" u shkaktua nga një video virale e një shitësi ambulant tunizian që po vetëdigjej, një incident i vetëm i çoi në kulm frustrimet e akumuluara prej kohësh të të rinjve shqiptarë. Kur banorët vendas dhe ambientalistët në fshatin bregdetar të Zvërnecit – vendi i një resorti të ri turistik të planifikuar të lidhur me Jared Kushner, një fond me bazë në Katar dhe oligarkë vendas — protestuan kundër rrethimit të një plazhi publik rreth një vendi natyror të mbrojtur, dy oficerë privatë sigurie zvarritën një nga banorët vendas nëpër rërë ndërsa policia vendase vëzhgonte. Protesta publike ishte e menjëhershme.

Ajo që filloi si një protestë e izoluar në një fshat të largët u zhvendos shpejt në kryeqytet, duke u rritur aq shpejt sa mediat kryesore, kryesisht vetëcensuruese, nuk mundën më të mbanin të mbuluar. Kanë kaluar pothuajse 4 javë dhe demonstratat tani ndodhin çdo ditë, me flamingon - vendas të Shqipërisë dhe të rrezikuar nga ndërtimi i resortit - si simbolin e tij unifikues. Protestat janë si të zemëruara - duke bërë thirrje për përmbysjen e të gjithë establishmentit politik dhe mediatik - ashtu edhe festive. Ashtu si me shumë kryengritje të tjera të Gjeneratës Z, solidariteti politik është përhapur përmes humorit dhe memeve. Një brez i mëparshëm i qetë i shqiptarëve po ndjen një ndjenjë të re dinjiteti dhe agjencie politike.

Mbulimi mediatik perëndimor i ka paraqitur demonstratat në mënyrë të ngushtë si të drejtuara kundër projektit Kushner - një grep më i lehtë për lexuesit e tyre në vend. Janë vendosur gjithashtu edhe robotë autoritarë të mediave sociale, duke e paraqitur rebelimin si një lloj qëndrimi kundër kolonializmit amerikan dhe izraelit.

Por ankesat e vërteta lidhen tërësisht me qeverisjen e brendshme. Dhjetëra mijëra shqiptarë të të gjitha llojeve ideologjike - liberalë, nacionalistë, ambientalistë, marksistë, influencere të modës dhe madje edhe teoricienë të skajshëm konspiracioni - mblidhen çdo mbrëmje sepse ndihen të privuar nga e drejta e votës dhe të braktisur nga një elitë egoiste - përfshirë edhe opozitën formale në parlament, Partinë Demokratike - e cila ka zhveshur asetet publike përmes marrëveshjeve të errëta dhe të ëmbla me interesa të veçanta për vite me radhë. Vendimi i Kushnerit për t'u dhënë dritën jeshile ishte vetëm shembulli më i fundit dhe më i spikatur. Rama është përpjekur të argumentojë se projektet luksoze të turizmit si ai i Kushnerit janë e ardhmja e ekonomisë. Demonstruesit nuk po e pranojnë këtë. Shqipëria është ende një vend i varfër dhe një model zhvillimi i bazuar kryesisht në ndërtim dhe turizëm vetëm sa i ka pasuruar ata me lidhje të mira, ndërsa i ka larguar votuesit e rregullt nga kënaqësitë e thjeshta të një pushimi veror në bregdet. Korrupsioni i përhapur në qeverinë e Ramës është bërë gjithashtu shumë i vështirë për t'u përballuar nga qytetarët. Refuzimi i fundit i Ramës për të hequr imunitetin parlamentar për ish-zëvendëskryeministren e tij, e cila po përballet me një aktakuzë, po krijon një pengesë të madhe në përparimin e Shqipërisë në bisedimet e pranimit në BE. Kjo shihet gjithashtu si një kërcënim më i gjerë për reformat popullore të sundimit të ligjit, të kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat Rama deri vonë i kishte përqafuar si të vetat.

Rekordi i protestave të Gjeneratës Z në mbarë botën ka qenë padyshim i përzier, dhe Shqipëria nuk ka zgjedhje deri në vitin 2029. Por këto demonstrata të veçanta kanë bërë një gjë të rëndësishme: Ato kanë dëmtuar reputacionin e kryeministrit karizmatik si dikush që është gjithmonë në gjendje të flasë për të dalë nga një situatë. Një brez në rritje po përpiqet të gjejë një mënyrë për të mobilizuar pakënaqësinë publike në politikën zgjedhore. Dhe për herë të parë në karrierën e tij të gjatë, Rama duket se nuk është në gjendje të thotë fjalën e fundit. Kjo mund t'i kushtojë edhe më shumë.

©Shkruar nga Agon Maliqi, analist politik nga Kosova dhe bashkëpunëtor i lartë në Këshillin Atlantik. Ai jeton në Tiranë.

LUTFI DERVISHI

ZGJIDHJA NGA SHESHI, POLITIKA APO SPAK?



Pas tre javësh proteste të pandërprerë në bulevardin kryesor të Tiranës, jemi në një terren të paeksploruar. Zhvillimi më interesant i ditëve të fundit nuk matet më me metra katrorë të mbushur apo me numrin e saktë të pjesëmarrësve, edhe pse injeksioni i fundit nga diaspora, me qytetarë të ardhur posaçërisht nga Londra, Berlini, Brukseli etj i dha tubimit një përmasë të re legjitimiteti moral.

Pas tre javësh, duket sikur qeveria punon ditën, ndërsa në mbrëmje protestuesit dalin në shesh dhe artikulojnë të njëjtat kërkesa.

Ky konfigurim është sa i pazakontë, aq edhe i rrezikshëm për vetë lëvizjen: protestat lindin për të krijuar krizë dhe për të detyruar palën tjetër të reflektojë, por kur zgjasin pa prodhuar bllokim institucional, rrezikojnë të kthehen në pjesë të peizazhit (të mbrojtur) urban, një ritual ku secila palë e kryen rolin e vet pa e cenuar tjetrën.

Të gjithë aktorët janë në presion për të lëvizur: sheshi është në presion për të (mos) prodhuar alternativë, pushteti për të ndryshuar, opozita për t'u përshtatur dhe SPAK për të vepruar.

Pyetja "kush lëviz i pari" nuk supozon se lëvizja e parë do ta zgjidhë krizën. Por ka një pyetje më të thellë që i paraprin: edhe nëse Kryeministri lëviz, me dorëheqje apo me riformatim, kush e zëvendëson?

Këtu shfaqet dobësia strukturore e "Revolucionit të Flamingove": ai lindi si refuzim i një modeli, jo si projekt pushteti. Sheshi nuk kërkon vetëm largimin e Ramës; ai refuzon njëherazi një pjesë të elitës politike, ekonomike dhe mediatike. Refuzimi total, pa një alternativë të organizuar gati ta zëvendësojë atë që rrëzohet, e lë boshllëkun e pushtetit hapur për këdo që mund ta mbushë, përfshirë vetë ata që sot sheshi i refuzon.

Algoritmi, fajtori i radhës

Kryeministri ka zgjedhur një strategji komunikimi që synon normalizimin përmes shpërfilljes. Ndërsa sheshi thërret prej tri javësh "dorëheqje", kreu i qeverisë flet për algoritmet dhe manipulimin digjital të opinionit publik, një manovër e mirëllogaritur diversioni. "Le të flasim për algoritmin dhe natyrën e rrjeteve sociale, por jo për zanafillën dhe shkaqet e revoltës: transparencën, vendimmarrjen e mbyllur, arrogancën e pushtetit dhe abuzimet.

Kjo lojë ka megjithatë një kosto reciproke. Duke sulmuar algoritmet, kryeministri pranon indirekt se ka humbur monopolin mbi narrativën publike. Por 82 (plus 3) votat në Parlament i mundësojnë ende të "shijojë memet" e protestës dhe të presë. Pa një mekanizëm/presion që e detyron politikisht të lëshojë pe, ai pret lodhjen e sheshit.

Do të kemi bashkëjetesë paqësore me protestën? Radikalizim? Krisje nga brenda apo goditje nga "jashtë"?

1. Normalizimi

Kjo është vija ku qeveria ka investuar më shumë. Protesta vijon, numrat (plus -minus)mbeten, por vëmendja zbehet, sidomos ajo ndërkombëtare, dhe sheshi kthehet gradualisht në ritual. Në këtë skenar humbet forca transformuese, pa zgjidhur asgjë në thelb.

2. Radikalizimi

Forca më e madhe e protestës deri tani ka qenë karakteri i saj paqësor dhe qytetar, që ka tërhequr familje, të rinj dhe diasporën. Çdo rrëshqitje drejt dhunës do t'u jepte ndërkombëtarëve pretekstin për t'u distancuar dhe qeverisë kartën e "viktimës së destabilizimit", një rrugëdalje që i jep fund energjisë së sheshit pa i dhënë fund krizës që e gjeneroi atë. Rritja e presionit pa kaluar në dhunë mund të jetë një opsion për të thyer "ekuilibrin"

3. Krisja nga brenda

Largimi i një deputeteje nga shumica nuk i trondit numrat, por krizat politike nuk fillojnë kur largohen shumë njerëz, por kur njerëzit e rëndësishëm të sistemit fillojnë ta shohin largimin si opsion racional për mbijetesën e tyre.
Nëse presioni i rrugës arrin të krijojë dyshime brenda PS-së, hapet një lojë tjetër. Por edhe kjo lojë mbetet brenda të njëjtës klasë politike që sheshi po refuzon në tërësi.

Këtu qëndron edhe sfida e opozitës, tradicionale dhe të re.

Ka një rezervuar të madh pakënaqësie, por jo domosdoshmërisht besimi ndaj opozitës. Opozita tradicionale duhet të tregojë se mund të jetë më shumë sesa përfituese pasive e kësaj pakënaqësie, ndërsa opozita e re duhet të provojë se di ta shndërrojë energjinë qytetare në organizim dhe alternativë politike. Nëse asnjëra nuk arrin ta lexojë këtë mesazh, atëherë boshllëku i përfaqësimit do të mbetet po aq i madh sa vetë pakënaqësia në shesh.

4. SPAK-u dhe ndërkombëtarët

Në këtë ekuilibër delikat ekziston një aktor që nuk mban fjalime në podium, por merr duartrokitje dhe që ka potencial për të përshpejtuar procesin: SPAK-u.

Deri tani SPAK-u ka treguar se mund të ndryshojë karriera politike dhe balanca pushteti më shpejt sesa vetë zgjedhjet. Protesta dhe SPAK-u veprojnë në dy plane plotësuese: protesta prodhon legjitimitet shoqëror dhe mban ndezur vëmendjen mbi korrupsionin, ndërsa SPAK-u prodhon pasoja institucionale dhe penale që (nuk) varen nga numri i kartonëve në Kuvend.

Protestat rrallë kanë triumfuar vetëm nga presioni i rrugës, por ato kanë fituar kur ky presion "koincidon" me çarje në elitë, me ndërhyrje institucionale ose ndryshime në kalkulimet e faktorëve ndërkombëtarë.

Këtu hyn në lojë edhe faktori ndërkombëtar. Ambasadat udhëhiqen nga parimi i stabilitetit, por ky stabilitet nuk është i pakushtëzuar.

Për Uashingtonin dhe Brukselin, mbështetja për reformën në drejtësi mbetet e palëkundur. Ata nuk do të mbajnë anën e opozitës për të rrëzuar një qeveri në rrugë, por do të kërkojnë reflektim institucional nëse dosjet e SPAK-ut prekin nivele që cenojnë besueshmërinë e shtetit.

Nëse ditët apo javët në vijim sjellin zhvillime të rëndësishme nga drejtësia mbi dosjet e nxehta, përfshirë Zvërnecin, krijohet ajo që mund të quhet "konvergjencë presionesh": nga poshtë (sheshi), nga brenda (drejtësia) dhe nga jashtë.

5. Kalendari

Ka edhe një lloj presioni që nuk varet as nga lodhja e protestuesve, as nga numri i tyre: afatet fikse.

Procesi i integrimit në BE dhe çdo angazhim ndërkombëtar me datë të caktuar, (mbyllja e kapitujve të negociatave, samiti i NATO-s...), janë momente kur Tirana zyrtare duhet të paraqitet si një vend normal.

Krizat politike që përplasen me axhendenja bëhen më të vështira për t'u shtyrë pafundësisht sesa ato që varen vetëm nga rezistenca e brendshme e palëve. Presioni mund të vijë jo nga një natë proteste edhe më e madhe, por nga një datë në kalendar që askush, as në shesh dhe as në qeveri, nuk e kontrollon plotësisht.

Dita e 21-të tregon se qeveria mund ta lodhë protestën nëse ajo mbetet thjesht një marshim nate.

Protesta mund ta lodhë qeverinë nëse arrin të prodhojë kosto politike përtej sheshit. SPAK-u mund të tronditë sistemin nëse hetimet e tij prekin nyje të rëndësishme të pushtetit, por asnjëri prej këtyre faktorëve nuk e zgjidh i vetëm krizën.
Kushdo qoftë, lëvizja e parë do të detyrojë të tjerët të ridizajnojnë të gjithë strategjinë e tyre.

BOJA E OKTAPODIT

SONILA MEÇO

Edi Rama nuk po rreket të fitojë ndaj protestës, por ndaj kohës.

Çdo ditë që kalon duke folur për gjithçka tjetër, përveç pesë kërkesave të protestës, është një ditë e fituar për të. Çdo debat anësor, çdo diversion, çdo provokim, çdo polemikë e re, ka vetëm një funksion, ta zhvendosë vëmendjen nga çështja më e rrezikshme për të: A do të funksionojnë institucionet apo do të vazhdojmë të jetojmë në republikën e një njeriu të vetëm?

Kjo është arsyeja pse nuk flet për pesë kërkesat e formuluara nga protestuesit. Nuk i përmend, as i kundërshton, nuk i pranon, nuk i debaton. Sillet rreth tyre si një anije e trembur rreth një mine detare.

U druhet fuqisë së tyre, i shmang si djalli temjanin sepse nëse hyn tek kërkesat, del nga territori ku ka shirë e korrur 13 vite, narrativa e kontrolluar. Po foli për kërkesat hyn në terrenin ku mund t'i shembet mbrojtja dhe u jep pushtet për herë të parë institucioneve.

Ato institucione që i zhvlerësoi, i shkatërroi, i mori nën hyqëm e i shndërroi në fasada sistemi të kapur kryekëput prej tij. Aty mori fund republika, shteti, kushtetuta.

Dhe për herë të parë po i kërkohet mos luaje shah me veten dhe jo në gambitin që i do xhani.

Protesta nuk po i kërkon as dialog, as negociatë, as bindje morale. Mençurisht po i dikton kosto politike, kosto ndërkombëtare dhe më në fund kosto institucionale. Protesta nuk i lutet Ramës, por i paraqet kushte sistemit.

Mu bash këtu bëhet interesante deklarata e tij për Financial Times, madje në një lëvizje të çoroditur e ka kapur shah mat mjeshtrin e diversionit. Rama tha se nuk i takon atij të provojë nëse është apo jo "Godfather". Atëherë kujt i takon?

Kjo është elementare, u takon atyre institucioneve që u ndërtuan, u financuan dhe u reklamuan për vite me radhë edhe nga Brukseli e Washington-i si garancia se askush nuk do të ishte mbi ligjin. Kjo është prova e shtetit ligjor.

Me një përgjigje vërtetë gojëndyrë, por të sinqertë në Financial Times, kryeministri ia lehtësoi punën dhe SPAK-ut.

Kjo është arsyeja pse protesta po arrin



qëllimin e nuk varet më nga numri i njerëzve në shesh. Krejt jashtë çdo parashikimi të Ramës, ajo ia doli ta shfaqë drejtësinë pa alibi në justifikimin e mungesës së saj drejt kreut.

Është vetë SPAK që po dëshmon se korrupsioni ka organizatë, krimi ka organizatë, pastrimi i parave ka organizatë, kapja e shtetit ka organizatë. Atëherë si do ta amnistojë njeriun që ka qeverisur i vetëm për trembëdhjetë vjet?

Në politikë ekziston një rregull i vjetër që edhe Macron e Meloni e dinë fare mirë: kur kostoja e mosveprimit bëhet më e lartë se kostoja e veprimit, sistemi lëviz.

SPAK-u nuk ka asnjë mundësi tjetër veçse të lëvizë drejt Edi Ramës.

Andaj diversionet e përditshme që sforcueshëm prodhon janë kaq të parëndësishme. Një ditë një video, një ditë një status, një ditë një intervistë, një ditë një armik i ri nga frëngjia e rrjeteve sociale. Kjo është teknika e huazuar nga oktapodi, kur i rrezikohet koka, lëshon bojë që të mos shihet.

Kjo protestë i ka idetë të qarta. Pesë kërkesat e protestës janë ende aty. Të pandryshuara. Të papërgjigjura.

S'po kërkohet një hero a shpëtimtar i ri. Protesta nuk po kërkon vetëm një akt politik, por edhe precedentin që ndan republikën nga sulltanati.

Që për herë të parë, njeriu që ka qeverisur si autor i modelit 13 vjeçar të paraqitet para ligjit si subjekt i saj.

Që për herë të parë në historinë e këtij tranzicioni, institucioni të guxojë të trokasë në derën e pushtetit pa kërkuar leje nga brenda.

Ndaj e do të lodhur e të sfilitur protestën kryeministri, sepse e di se sa më gjatë të vijojë e rezistojë kjo dallgë zemërate, aq më pak do të ketë rëndësi se çfarë thotë Edi Rama, e aq më shumë do të ketë rëndësi se çfarë bën SPAK-u.

'ENVERI I DYTË'-PIKTORI NDËRTON NJË SHQIPËRI KU NUK DO TË KETË VEND PËR SHQIPTARËT!

KIM MEHMETI

Të rinjtë që protestojnë në Tiranë, në mos më shumë, ia dolën të shpalosin një të vërtetë: se Shqipëria është një vend që sheh ëndrra demokratike, por që bën gjumë në shtratin e mendësisë enveriste.

Por me një dallim: Enveri i kohës komuniste e bëri Shqipërinë burg për shqiptarët, ndërsa "Enveri i Dytë" – Piktori – po ndërton një Shqipëri ku nuk do të ketë vend për shqiptarët.

Kush nuk e beson këtë, le ta marrë e ta shfletojë librin "The Albanian Files" (Dosjet e Shqipërisë), ku do të shohë se si pronari i vetëm i Shqipërisë – Piktori – i ka porositur arkitektët e botës që t'ia ndërtojnë një Shqipëri që do t'i dëbojë shqiptarët.

Dhe ka vite që ai e ka nisur ndërtimin e asaj Shqipërie, i papenguar nga askush.

Pjesë e atij ndërtimi ishte edhe rrënimi



i kujtesës shqiptare, si për shembull shndërrimi në gërmadhë i Teatrit Kombëtar në Tiranë, me çka vazhdoi ta shndërrojë Shqipërinë në një vend ku do të ketë pleq për të vdekur, por jo edhe të rinj për të lindur fëmijë dhe për t'i varrosur pleqtë që japin shpirt.

Dhe tani, kur kjo rini ia zbuloi planin shkatërrues ndaj shqiptarisë, plan që nuk u kishte shkuar ndërmend as armiqve më të mëdhenj të popullit tonë, atij nuk i ka mbetur gjë tjetër përveçse të bëjë çmos për t'i përçarë shqiptarët, duke i shpallur ata iranianë, serbë, grekë e çfarëdo tjetër.

Në të vërtetë, ai as nuk gënjen kur thotë se protestuesit janë "të huaj", sepse shqiptarët ai kurrë nuk i ka ndjerë si të vetët.

Andaj edhe kishte për qëllim që shqiptarët t'i zëvendësonte me të huaj të dëgjueshëm, të cilët nuk do ta ndjejnë këtë tokë si të tyren dhe, për rrjedhojë, as që do t'u pengojë kur ajo të shitet.

Që t'i përçajë dhe t'i dobësojë protestuesit që kanë mbushur bulevardet e Tiranës, ai pa dashje shpalosi edhe një të vërtetë tjetër: gjithmonë i ka ndjerë si të huaj dhe si armiq shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të mëmëdheut.

Më në fund, Piktori as që e di se Shqipëria është më e rëndësishme për shqiptarët që jetojnë jashtë saj sesa për ata që jetojnë në shtetin që ai e ka shndërruar në pronë të vetën, sepse pa të ata do të mbeteshin pa emër.

Ai nuk e kupton se nuk do të ekzistonte as kjo Shqipëri e vogël, të cilën ai e zhvat, po të mos ishte ëndërr mbarëshqiptare dhe po të mos kishin derdhur gjak për të edhe shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Luginës së Preshevës, Malit të Zi, Çamërisë e viseve të tjera shqiptare.

Ai nuk e ka përjetuar se sa keq ndihet shqiptari jashtë mëmëdheut kur Shqipëria ka një parlament me të cilin tallet e tërë bota dhe një kryeministër qesharak, sikur të ishte klloun cirku.

Nga ta dijë ai se çfarë tragjedie është për shqiptarin kur atë e përfaqëson një njeri të cilit i pengon që populli i tij të mendojë dhe të veprojë mbarëshqiptarisht.

Andaj, protestat në Tiranë do të dështojnë vetëm nëse Piktori arrin t'i përçajë protestuesit, gjë që do të ishte përfundimisht turpi më i madh i shqiptarisë dhe një leje e hapur për Piktorin që të vazhdojë të ndërtojë një Shqipëri ku nuk do të ketë më shqiptarë.



Dotech website

Akoma nuk jeni rregjistruar në Google?



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



Për çdo konsultim mund të vini tek zyrat tona

OUR SERVICES:

- BUSINESS CARDS
- BANNERS
- FLYERS
- VIDEO MARKETING

Contact Us

...

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT

FILLIMI I FUNDIT TË PUSHTETIT TË RAMËS

VETON SURROI

Fillimi i fundit mund të jetë mu ky moment, kur piqet bindja e rrëzimit të një kryeministri a qeverie a rendi - pra të një lloj bindjeje se gjërat nuk do të kthehen aty ku ishin para se të fillonte protesta



1.

Ndoshta këtë nuk e dinë kryeministri Rama, protestuesit, publiku i gjerë duke më përfshirë mua që po shkruaj, por kështu disi duket fillimi i fundit të një periudhe, fundit të një qeverisjeje, mbase fundit të një procesi

Fillimi i fundit duket kur një person si kryeministri Rama përpiqet për dy javë rresht të gjejë fajtorët pse qytetarët me rend e rregull deri tani të paprecedentë dalin për të kërkuar dorëheqjen e tij. Një listë e gjatë ekzotike fajtorësh u gjetën për këto dy javë, mes të cilëve "armiqtë e jashtëm" ishin edhe grekët që nuk dëshiruakan rritje të konkurrencës turistike në Shqipëri dhe iranianët, të cilët nuk kanë problem me konkurrencë turistike, por me Shqipërinë, e cila është ndër kërcënimet kryesore për regjimin e ajatollahëve. Armiqve të jashtëm tash u janë bashkëngjitur "armiqtë e brendshëm" që në fjalët e kryeministrit janë fryma fashiste që "nuk ka nevojë për uniforma dhe për armë. Fryma fashiste është fryma që thotë: "Shqipëria është e shqiptarëve", pra, të gjithë të tjerët jashtë nuk janë të mirëseardhur".

Kryeministri Rama ka mundur t'i shohë ndryshe protestuesit, qoftë edhe duke u nisur nga përvoja personale. Kur më 1990 e 1991 ai ishte protestues, udhëheqësit e Partisë në pushtet i quajtën fillimisht ato protesta si produkt të armiqve të jashtëm, dhe po, në mesin e tyre ishin edhe grekët e iranianët. Kur u rrëzua monumenti i Enver Hoxhës do të ketë qenë një numër udhëheqësish që i quajtën fashistë, këta shqiptarët që do të ishin si gjithë Evropa.

Kur të lexohet pa paragjykime "Shqipëria është e shqiptarëve" do të thotë sovranitet të qytetarëve të Shqipërisë. Ata që e kërkojnë sovranitetin nuk e ndiejnë këtë të rrezikuar nga Greqia, Irani, hebrenjtë, aziatikët, afrikanët apo "poliagjentët"; ata ndiejnë se sovraniteti i vendit, e drejta e qytetarëve për të vendosur për të, është i rrezikuar prej pushtetit. Apo më saktësisht, prej modelit të kapjes së shtetit në një ngjizje të politikës, korrupsionit, krimit të organizuar.

Fillimi i fundit i pushtetit është kur Udhëheqësi nuk mund ta përshkruajë realitetin që shihet nga dritarja.

2.
Fillimi i fundit i një periudhe është kur lind dhe zhvillohet një lëvizje kapilare e protestës si kjo. Pra, kur zhvillohet një lëvizje që nuk ka nevojë për prijës partiak por gjen një artikulim të përbashkët për rininë dhe të gjitha shtresat e vendit, posaçërisht brenda asaj të mesme që nuk ka gjetur identifikim prej militanti politik. Në rrugët e Tiranës dhe disa vendeve të Shqipërisë (me përkrahje edhe nga mërgata aty ku jeton) ditë më ditë rritet numri i protestuesve që kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit Rama. Dhe ky numër po rritet jo më nga mungesa e frikës prej reagimit të pushtetit, por nga mungesa e frikës nga vetja, frika se nëse nuk dalin janë duke humbur momentin e tyre historik. Qytetarët që po shtohen në rrugë nuk kanë dilemë a duhet dalë apo jo ngase janë të bindur se po marrin pjesë në një proces të cilit ende nuk ia dinë emrin (revoltë, revolucion, demonstratë) por janë të sigurt se ai proces do të përfundojë me pushtetin e kryeministrit të tanishëm, apo thënë më mirë me natyrën e atij pushteti.
Fillimi i fundit mund të jetë mu ky moment, kur piqet bindja e rrëzimit të një kryeministri a qeverie a rendi - pra të një lloj bindjeje se gjërat nuk do të kthehen aty ku ishin para se të fillonte protesta.

3.
Por fillimi i fundit nuk është fundi.
Kjo protestë mund të marrë përmasa e drejtime të ndryshme. Mund të jetë më e madhe dhe më dinamike (me bllokime rrugësh e të ngjashme, siç u paralajmërua) dhe kjo ka gjasa të ndodhë po aq sa ka gjasa që kryeministri të përpiqet të vazhdojë që ligjërimi i tij i arrogancës t'i mundë britmat për dorëheqje e burgosje.

Kryeministri mund të shpresojë që protesta të shpenzohet pas një kohe apo, siç ndodh në Serbi, që të arrihet një lloj akomodimi jetese me protesta, si një ritual ditor a javor.
Por, fillimi i fundit ka sjellë një rrafsh të ri politik.
Në të kryeministri, që ka legalitetin e pushtetit të fituar me zgjedhje, është duke e humbur legjitimitetin politik. Në rrugë janë njerëz si ai para 36 vjetësh. Çdo ditë e lëvizjes protestuese e përkrahjes qytetare për të është ditë erozioni e legjitimitetit politik për pushtetin i cili është ndërtuar si ofertë mu ndaj asaj klase e cila po proteston.
Në këtë rrafsh lëvizja protestuese është në betejë për të fituar legjitimitet politik. Fillimin tashmë e ka të fituar - të ngrihesh kundër një modeli kapjes së shtetit i ka dhënë dhe po i jep përkrahje gjithnjë e më të madhe. Por, kjo përkrahje do të kërkojë që të transformohet në realitet të ri legjitimiteti e legaliteti. Edhe po të përmbushet nesër kërkesa e dorëheqjes së kryeministrit Rama, në pushtet pasnesër nuk do të jetë një kryeministër e qeveri standardesh të demokracisë skandinave. Mbase ka të këtillë - brenda lëvizjes, parti të ndryshme politike, shoqëri civile - por ata mund të vijnë në pushtet vetëm pas zgjedhjeve të lira e të ndershme. E kapja e tanishme e shtetit është e ndërtuar mu si prodhim dhe pasojë e zgjedhjeve që nuk mund të quhen se përmbushin standardin e të qenit të lira.
Në ditët, javët e ndoshta edhe muajt në vijim në rrafshin e ri politik do të zhvillohet beteja në të cilën kryeministri do të përpiqet të ruajë legjitimitetin e veprimeve e lëvizja protestuese ta fitojë atë. Kryeministrit nuk do t'i ndihmojë arroganca, kontrolli i deritanishëm mediatik e as hapësira ku ka qenë inovativ dhe prijës, ajo e medieve sociale. Arroganca e tij vetëm sa do ta ushqejë lëvizjen protestuese e cila tashmë e ka tejkaluar kryeministrin në medie sociale dhe po vendoset si favorit edhe në televizionet deri dje të afërta me pushtetin.

Lëvizjen e protestës nuk do ta ndihmojë besimi se ka të drejtë; varrezat politike janë të mbushura me vetëbesimin në kauza të drejta.
4.
Lëvizja protestuese e ka të vështirë në këtë moment të projektojë se çfarë është fundi i cili ka filluar tani. Është një lëvizje kapilare, heterogjene që ndoshta do të jetë bërthama e një grupacioni politik të aftësuar për zgjedhje dhe për ta qeverisur vendin; ndoshta jo.

Por, kryeministri është ai që në pozitën të cilën e ka mund ta shohë fundin. Kjo pozitë ia mundëson edhe të marrë pjesë në projektim të tij. Fund quhet ndërprerja e qeverisjes në të cilën janë integruar bashkërisht e pandashëm interesat politike, korrupsioni, elita oligarkike dhe krimi i organizuar në krye të së cilës është garanca autokratike. Fund quhet krijimi i një konsensusi shoqëror, në të cilin do të marrë pjesë edhe ai, për kushte për zgjedhje të lira e të drejta, të pranuara nga të gjithë pjesëmarrësit.

"Kur papritmas, në mesnatë, ndigjon
nji procesion të padukshëm tue kalue pranë,
me muzikë të përsosun, me zana të hollë,
mos vajto fatin tand, tash që po të len,
që punët të shkuen mbrapsht, që planet tueja
dolën krejt mashtrim;
mos vajto kot për to".

Konstandin Kavafi, poeti i famshëm grek nga Aleksandria, kështu përshkruan natën e fundit të Mark Antonit, gjeneralit romak i cili ishte rrethuar gjatë nga forcat e Oktavianit. Legjenda të cilën e përshkruan Plutarku ishte se pas shumë betejave në rrugët e Aleksandrisë u dëgjua poezia e muzika, kishte art e hare, dhe ky ishte sinjali i ndryshimit. Në fjalët e Kavafit, kryeministri i Shqipërisë duhet të dëgjojë, pas betejave politike, artin e rininë, muzikën dhe harenë e rrugëve të Tiranës:
"Mbi të gjitha, mos e mashtro veten, mos thuaj
se kjo qe andërr, se veshët të rrejtën;
mos e ul veten me shpresa të kota si këto.
Bahu si ai që prej kohësh asht përgatitë, me nurin e kurajës,
si i ka hije atij
që u gjet i denjë për nji qytet të tillë".
Dhe, një porosi përfundimtare për ballafaqimin me realitet e me dinjitet:
"Shko i vendosun te dritarja,
ndigjo me mall të thellë,
pa qarravitjet e pa arsyetimet e frikacakëve,
ndigjo – kënaqësinë tande të fundit – zanat,
muzikën e përsosun të këtij procesioni të çuditshëm,
e thuaji lamtumirë Aleksandrisë
që po të humb prej duersh".

(Konstandin Petro Kavafi "Zoti e braktis Antonin", botuar në 1911. Këtu u dha shqipërimi gegnisht, një afrim formës jostandarde të shprehjes së poetit në greqishten e tij)

BIRN: MILIONAT E KOKAINËS NË HOTELET E LUKSIT NË BREGDET DHE NË TIRANË

Hetimi më i fundit i prokurorisë së posaçme zbuloi një rrjet tjetër të stërmadh të trafikut të drogës dhe pastrimit të parave me bazë në Elbasan, ku dhjetëramiliona euro u investuan në ndërtim, në turizëm e tregti, ose thjesht u fshehën në muret ndarëse të apartamenteve që bliheshin posaçësisht për këtë qëllim.

Në shtator të vitit 2020, Isa Aliu, 54 vjeç nga Elbasani, shkëmbeu një makinë për një tokë me vlerë 4.1 milionë lekë. Problemi është se makina ishte blerë më herët për 900 mijë lekë dhe, sipas të dhënave të siguruara nga prokurorët nga regjistri i udhëtimeve ndërkufitare, vijoi të përdorej nga Aliu edhe pas shitjes së supozuar.

Prokurorët thonë se transaksioni, dukshëm i pavërtetë, ishte pjesë e një morie veprimesh në shërbim të Salvatore Aliut, vëllait të Isait, person përgjegjës për trafikimin e një sasie të stërmadhe droge, së paku 50 tonë kokainë, fitimet e së cilës mund të arrijnë në qindramilionë euro dhe që janë konvertuar në pasuri të ndryshme me vlerë së paku 150 milionë euro të identifikuara në 491 prona të ndryshme dhe 209 llogari bankare.
Një vendim i GjKKO-së për vendosjen e masës së sekuestros preventive mbi pasuritë e dyshuara si të rrjedhura nga proceset e pastrimit të parave të këtij grupi, detajon nga njëra anë aktivitetin e trafikut të drogës në përmasa të stërmëdha dhe nga ana tjetër, proceset e kamuflimit të burimit të parave përmes investimeve fiktive dhe deklarimit të fitimeve të paqena, kryesisht në sektorin e ndërtimit, por edhe në tregtinë me pakicë dhe turizmin.

Hetimi është realizuar falë të dhënave të siguruara nga përgjimi nga autoritetet franceze të komunikimeve të kryera nga grupet kriminale përmes aplikacionit Sky ECC. Përgjimet i përkasin periudhës nëntor 2019, prill 2021. Hetimi është nisur nga Prokuroria e Posaçme në bazë të një referimi nga Policia e Shtetit në vitin 2020 dhe është realizuar nga prokurorët Klodjan Braho dhe Doloreza Musabelliu.

Isa Aliu, aktiviteti i parë ekonomik i të cilit ishte një kompani tregtie me pakicë e quajtur Road House në Elbasan, hapur në vitin 2008, por fuqizuar veçanërisht pas vitit 2020, konsiderohet nga prokuroria si personi kyç përgjegjës për pastrimin e parave. Grupi i drejtuar nga i vëllai, Salvatore Aliu, konsiderohet si grupi përgjegjës për trafikimin e pesëdhjetë tonelatave kokainë nga Amerika Latine për në Evropë, nga të cilat afro 9 tonë janë kapur. Kapjet dhe sasitë e tjera të vlerësuara të trafikuara i përkasin vetëm periudhës gjatë së cilës Sky ECC ka qenë nën përgjim. Se çfarë ka ndodhur para nëntorit 2019 dhe pas prillit 2021, kjo mbetet vetëm për t'u marrë me mend.

Sipas të dhënave të dosjeve të tjera hetimore të para nga BIRN, kokaina blihet zakonisht për 7 mijë dollarë për kilogram në vendet e origjinës ndërsa transporti e rrit koston në afërsisht 10 mijë euro. Pasi del në Evropë, kokaina shitet me shumicë për 25-30 mijë euro për kilogram. Nëse supozohet se 9 nga 50 tonët që i janë identifikuar këtij



grupi janë zënë nga policitë e vendeve të ndryshme evropiane, zëniet e drogës duket se e rrisin koston totale të sjelljes nga Amerika Latine në Evropë me afro 20% të tjera. Trafikantëve u mbetet në këtë mënyrë një normë fitimi prej 200 deri në 250% mbi kostot. Xhiroja totale e të pesëdhjetë tonëve të shitur me çmim shumice vlerësohet në shifrën e pabesueshme së paku një miliardë euro. Fitimet bruto nga një tregti e tillë arrijnë me lehtësi në qindra milionë euro.

Zbulimet e prokurorisë nga pronat që i përkasin këtij grupi vlerësohen në 150 milionë euro.

Beton dhe para të thata

Gjithsej dhjetë shtetas, përfshirë të njohurit Eldi Dizdari dhe Dritan Gjika, janë identifikuar nga prokuroria si përgjegjës për trafikimin e drogës, ndërsa shumë të dyshuar të tjerë nuk janë identifikuar dot. Prokurorët në të gjithë botën shpenzojnë shumë burime për të identifikuar përdoruesit e aplikacionit Sky ECC si dhe për të provuar përdorimin e këtij aplikacioni nga të dyshuarit përkatës përmes të dhënave rrethanore, të tilla si biseda me elementë faktikë të lidhur me ngjarje të dokumentueshme. Por shumë nga përdoruesit e Sky ECC mbeten gjithsesi të paidentifikuar dhe të paidentifikueshëm.

Sa i përket pastrimit të parave, prokurorët besojnë se Isa Aliu dhe Nikollë Bibaj janë identifikuar si kryesorët. Detyra e tyre ishte që të fshihnin një pjesë të parave në mënyrë fizike, me fuçi apo në muret ndarëse të apartamenteve të blera posaçërisht për këtë qëllim. Një pjesë transformohej në kompani dhe prona të patundshme gjithkund nëpër Shqipëri, përfshirë hotele luksi, dukshëm investime të tepruara për tregun shqiptar, por që, për shkak se trafikantët kishin ngut për të materializuar paratë e thata, kostot dhe fitimet potenciale nga investimet kishin rëndësi dytësore.
Komunikimet në Sky ECC japin të dhëna për transferimin në Shqipëri të së paku 30 milionë eurove cash. Në datën 30 gusht 2020, Isai informon të vëllain se ka në gjendje cash 6 milionë euro, ndërsa dy javë më vonë, më 15 shtator, gjendja cash është rritur në 9.8 milionë euro. Dy ditë më herët, më 13 shtator, Salvatore njofton të vëllain se do t'i sjellë 20 milionë euro. Ai e instrukton të vëllain që të fshehë paratë në fuçi apo të blejë apartamente për t'i përdorur vetëm për fshehjen e topave me para në hapësirat bosh mes mureve ndarëse.

Aliu Road House ishte një rrjet dyqanesh për mallra të përziera në qytetin e Elbasanit, themeluar fillimisht nga Isa Aliu në vitin 2008 dhe që, deri në vitin 2020, shënonte vit pas viti humbje. Humbjet e akumuluara arrinin në afro 18 milionë lekë (rreth 180 mijë euro me kursin e sotëm).

Fati i kompanisë ndryshoi në këtë kohë, vëren Prokuroria, kur në vitin 2021, ajo deklaroi fitime neto në masën 109 milionë lekë. Kompania u angazhua në sektorin e ndërtimit, fillimisht si nënkontraktore për ndërtim banesash, por që sipas prokurorëve, plani ishte i qartë: deklarimi i fitimeve të paqena për të justifikuar ekspansionin e planifikuar nga grupi në sektorin e ekonomisë së ligjshme.

"Përpara kësaj periudhe", vërejnë prokurorët, kompania "nuk ka patur infrastrukturën e nevojshme për futjen në tregun e ndërtimit, si dhe nuk ka patur kapital të lartë qarkullues për zhvillimin e këtij aktiviteti."

Kjo nuk e ndaloi kompaninë që, në dy vitet që pasuan, të hynte si investitor në dy projekte fantazmagorike zhvillimi në zonën e Gjirit të Lalzit. Në kompleksin Lalzi Marina Seaside kompania investoi 30 milionë euro për ndërtimin e 90 mijë metrave katrorë, ndërsa në kompleksin Porto Lalzi Villas investoi 12 milionë euro.

Mënyra se si kompania u përpoq të pastrojë milionat e trafikut të drogës ishte duke marrë përsipër punime ndërtimi përkundrejt apartamenteve dhe vilave të gatshme, një skemë shkëmbimi në natyrë që duket se shkrihet me praktikën e zakonshme të biznesit shqiptar.

Kompania Aliu Road House duket se ka hyrë në marrëveshje blerjeje edhe për pjesën më të madhe të një pallati në ndërtim në Qerret, ka blerë me klering përkundrejt punimeve me vlerë 1.5 milionë euro te Lura 5 në Gjirin e Lalzit dhe afro 400 mijë euro apartamente në një pallat tjetër në Golem.

Krahas aktiviteteve të tilla, kompania reklamon në faqen e saj të internetit se ka fituar punë publike gjatë procesit të rindërtimit nga tërmeti i vitit 2019 në Durrës. Procesi i rindërtimit i kushtoi taksapaguesve shqiptarë dhe donatorëve të huaj mbi 1 miliardë euro dhe ka vijuar deri sot e kësaj dite, pothuajse shtatë vjet pas tërmetit. Por qeveria qendrore dhe bashkitë i kanë kryer prokurimet e rindërtimit përmes instrumentit të gjendjes së jashtëzakonshme, gjë që siguron konkurrencë të ulët dhe fitime të larta për kompanitë fituese.

Ky nuk është rasti i parë ku kompani të lidhura me krimin e organizuar identifikohen si fituese të kontratave publike, veçanërisht në procesin e rindërtimit nga tërmeti.

Zgjerimi me vlerë 100 milionë euro

Deri në këtë pikë, Isa Aliu, përmes kompanive të tij të ndryshme, (përfshirë një kompani të sigurisë fizike, një aktivitet me licencë nga Ministria e Brendshme, e cila duket se është shumë tërheqëse për grupet kriminale për shkak të autorizimit që bart për mbajtje armësh dhe qarkullim me njerëz të armatosur), kishte vënë në qarkullim dhjetëramiliona euro, të trupëzuara në qindra tituj pronësie, toka, apartamente, vila e të tjera. Por nga viti 2025, Aliu dhe mbështetësit e tij, deri në këtë kohë, tërësisht të panjohur, duket se patën ambicien të hynin në sipërmarrje akoma më të mëdha. Një hotel me pesë yje në Jalë të Vunoit, në bredgetin e Jonit. Sipas vendimit të gjykatës, projekti, i cili nuk u vu në lëvizje, kërkonte investime prej së paku 100 milionë euro. Projekti, të cilit i është referuar si ZIG-ZAG për shkak të formës tëpjetë kodrës mbi det, supozohet se do të ndërtohet në një kodër në jug të gjirit të Jalit, pranë plazhit të Gumës.

Krahas linjës së vëllezërve Aliu, dosja analizon aktivitetin e vëllezërve Sokol, Nikoll e Shpëtim Bibaj. Hetimet kanë zbuluar se Sokol Bibaj është furnizuar me drogë nga Salvatore Aliu në nivelin e tonelatave, ndërsa në një nga bisedat e përgjuara, ai i ka treguar Salvatorit se bën edhe tetë tonë në javë.

"Do e drogojmë Evropën," thotë ai, duke nënkuptuar sasitë e stërmëdha të trafikuara. Vëllezërit e tij, Nikolla dhe Shpëtimi kujdeseshin në Shqipëri për legjitimimin e shumave monetare, kryesisht përmes kompanive të ndërtimit. SPAK vëren se në shumë raste, këta janë angazhuar në shit-blerje aksionesh në kompani të ndryshme përmes shumave që nuk kanë sens nga pikëpamja ekonomike. Veprimi i parë fiktiv është kur Shpëtim Bibaj blen 70% të kuotave të një kompanie me vlerë nominale 19 milionë lekë pasi paguan zyrtarisht vetëm 1.2 milionë lekë.

"Transaksioni është kryer 15.5 herë nën vlerën nominale," vëren SPAK. "Kjo zbritje ekstreme dhe e panatyrshme provon se çmimi është fiktiv."

Një nga skemat e përdorura për pastrimin e parave, sipas dyshimeve të prokurorisë, ka të bëjë me lehtësinë e krijuar nga qeveria aktuale që nga viti 2015 e pas, në të cilën, biznesi i vogël nuk i nënshtrohet tatimit mbi fitimin. Kështu, Shpëtim Bibaj deklaroi në vitin 2021 afërsisht 10.4 milionë lekë nga aktiviteti i një kompanie person fizik, shumë parash të cilën ia dha hua kompanisë së ndërtimit që kishte blerë me çmim 15 herë më të ulët se sa vlera nominale.

Pas këtyre qarkullimeve fillestare, të dyshuarit u angazhuan në investime të mëdha në sektorin e ndërtimit, përfshirë pallate në zonën e ish-Porcelanit në Tiranë ku u blenë 89 njësi të ndryshme me vlerë miliona euro.
Kompania F & XH Cons sh.p.k, nën pronësinë e Bibajve ndërtoi një hotel me katër yje në Tiranë në Rrugën e Dibrës, me markën Melia. Në një nga fotot e publikuara nga hoteli në Instagram, paraqitet një pikturë e varur në mur e aktorit Marlon Brando në rolin e Vito Korleones te filmi Kumbari. Hoteli është një nga objektet e vëna nën sekuestro preventive.

Prania e parave të drogës në sektorin e ndërtimit në Shqipëri është diskutuar gjerësisht gjatë viteve të fundit. Kryeministri Edi Rama gjithsesi i cilëson akuzat si "broçkulla", ndërsa në një rast tjetër u ankua për atë që e cilësoi si "kriminalizimi i një sektori të rëndësishëm në ekonomi".
Numri i objekteve të ndërtimit apo i kompanive të ndërtimit të identifikuar nga prokurorët si destinacione të shpëlarjes së parave të drogës është në rritje të vazhdueshme.

(Reporter)

POROSISNI BANNER PËR BIZNESIN TUAJ



PVC BANNERS
MESH BANNERS
PREMIUM ROLLER
PULL UP ROLLER

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

Ne mund t'ju ndihmojmë

- Asylum & Immigration
- New Point Based System
- Settlement Applications (ILR)
- European Law
- Nationality&Travel Document
- Human Rights Applications
- High/Court of Appeals
- Over Stayers
- Work Premits
- Visa Extensions
- Judicial Reviews
- Tribunal Appeals



Konsultimet falas

07774222062

07878335000

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666



